

**MINISTRIA E BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL**

Nr. 1882 Prot.

Datë 19.2.2018

**MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË**

Nr. 3437 Prot.

Datë 22.2.2018

UDHËZIM

Nr. 1 Datë 19.2.2018

**PËR KRITERET, PROCEDURAT DHE MËNYRËN E ADMINISTRIMIT TË FONDIT TË
PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 6, pika 3, të ligjit nr. 9817, datë 22. 10. 2007, "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural", i ndryshuar, " të nenit 18, të ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të VKM nr. 701, datë 12. 10. 2016 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të peshkimit për periudhën 2016-2021", ligjit nr. 109, datë 30. 12. 2017 "Për buxhetin e vitit 2018"; të pikës 4, të VKM nr. 72, datë 7.2.2018, "Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2018", të VKM nr. 21, datë 12. 1. 2018, "Për disa shtesa në vendimin 709, datë 29. 10. 2014 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020", VKM nr. 22, datë 12. 1. 2018 "Për miratimin e kriterëve për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit", të Udhëzimit të Ministrisë së Financave, nr. 19, datë 3. 11. 2014 "Për zbatimin e regjimit të veçantë të masës së kompesimit të prodhimeve bujqësore, për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar",

UDHËZIJMË:

I. NDARJA E FONDIT TË PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL

Fondi prej 2 565 000 mijë lekë, i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2018, ndahet sipas masave/grup-masave, si më poshtë vijon:

Nr i masës	Emërtimi i masës	Fondi i planifikuar në '000 lekë
1.	Mbjellje e mollës me kultivarë të kërkuar nga tregu, në vlerën 350 000 (treqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha për pemëtoret intensive, në vlerën 250 000 lekë/ha për pemëtoret me teknologji të përmirësuar;	21,315
2.	Mbjellje e qershisë me kultivarë të kërkuar nga tregu, në vlerën 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha;	13,050
3.	Mbjellje arrash me kultivarë të kërkuar nga tregu, në vlerën 300 000 (treqind mijë) lekë/ha për mbjelljet me fidanë të shartuar;	15,660
4.	Mbjellje e lajthisë dhe shegës me kultivarë të kërkuar nga tregu në vlerën 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha;	67,425
5.	Mbjellje gështenje në vlerën 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha;	7,830
6.	Mbjellje e ullinjve me fidanë autoktonë në vlerën 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha, për format intensive të kultivimit, dhe në vlerën 180 000 (njëqind e tetëdhjetë mijë) lekë/ha, për format tradicionale;	78,300
7.	Plotësimi i numrit të bimëve në ullishtet e vjetra/degraduara në masën 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë/ha;	1,513
8.	Mbjellje e agrumeve me kultivarë të kërkuar nga tregu, në vlerën 200,000 (dyqind mijë) lekë/ha;	20,880
9.	Mbjellje vreshti, me kultivarë për rrush tavoline në vlerën 300 000 (treqind mijë) lekë/ha dhe vreshta me kultivarë autokton për përpunim në vlerën 350 000 (treqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha;	45,240
10.	Mbjellje luleshtrydesh në serra dhe/ose tunele në vlerën 200 000 (dyqind mijë) lekë/ha;	13,920
11.	Mbjellje bimë medicinale dhe aromatike, të kultivuara si: timus, rigon, helichrysum italicum, trumza, çaj mali, rozmarinë, xhinxher dhe shafran në vlerën 200 000 (dyqind mijë) lekë/ha.	11,197

Sipërfaqja e mbjellë me kulturat e përcaktuara në masat me nr 1-11, të jetë jo më e madhe se 20 ha, sipas kategorive të mëposhtme:

- për fermerët individual jo më pak se 0.5 ha në një bllok të vetëm dhe jo më pak se 0.3 ha, kur i bashkëngjitet blloqeve ekzistuese;
- për grup fermerësh jo më pak se 1 ha, në një bllok të vetëm;
- për Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor (SHBB) jo më pak se 5 ha, ndërsa madhësia e ngastrës të jetë, jo më pak se 0.3 ha, kur nuk është në bllok.

Masa e financimit për sipërfaqe të mbjellë, të jetë:

- deri në 5 ha, me 100% të vlerës për ha;
- mbi 5.0 -10 ha (5 ha e dytë), të rritet me 25% të vlerës për ha;
- mbi 10.0 ha deri në 20 ha, të rritet me 50% të vlerës për ha.

Për fermerët me moshë nga 22 deri në 35 vjeç, masa e financimit të rritet me 25%.

Aplikuesi në çdo rast, duhet të ketë tokën në pronësi private dhe/ose të marrë me qira nga subjekte të

tjera që e kanë tokën në pronësi private.		
12.	Ndërtimi i serrave diellore për kultivimin e domates, kastravecit dhe specit, me sipërfaqe jo më pak se 0.2 ha dhe jo më shumë se 1 ha. Masa e financimit të jetë në 50% të vlerës totale të faturave tatimore të investimit të përfunduar, por jo më shumë se: 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë/dynym për serra me lartësi anësore jo më të vogël se 4 m, përfshirë dhe ujitjen me pika. 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë për dynym për sera me lartësi anësore jo më të vogël se 2.8 m, përfshirë dhe ujitjen me pika.	626,400
13.	Përmirësimin e teknikave të ujitjes nëpërmjet instalimit të ujitjes me pika në ullishte, vreshta, pemëtore, agrume, arvore dhe shegë (vetëm për format intensive të kultivimit të tyre), jo më shumë se 200 000 (dyqind mijë) lekë/ha. Financimi të bëhet për sipërfaqe jo më pak se 0.5 ha dhe jo më shumë se 5 ha;	5,046
14.	Instalimin e sistemit të ngrohjes me biomasë (pelet) në serrat me ngrohje, jo më shumë se 280 000 (dyqind e tetëdhjetë mijë) lekë për dynym. Financimi të bëhet për sipërfaqe jo më pak se 0.2 ha dhe jo më shumë se 1 ha;	7,308
15.	Zëvendësimin e plastmasit termik për serrat diellore ekzistuese, sipas specifikimeve të masës 12, jo më shumë se 750 000 (shtatëqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha. Financimi të bëhet për sipërfaqe jo më pak se 0.2 ha dhe jo më shumë se 1 ha;	26,100
16.	Prodhimin e bostanoreve në tunele (mulçerimin dhe mbulimin me plastmas termik), jo më shumë se 100 000 (njëqind mijë) lekë/ha. Financimi të bëhet për sipërfaqe jo më pak se 0.5 ha dhe jo më shumë se 5 ha;	26,100
17.	Rrjeta për mbrojtjen e prodhimit nga breshëri në blloqet ekzistuese të kulturës së mollës dhe qershisë, jo më shumë se 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë/ha. Financimi të bëhet për sipërfaqe jo më pak se 1 ha dhe jo më shumë se 5 ha;	3,915
18.	Polenizimin e kulturave perimore në serra me bletë polenizuese jo mjaltëdhënëse, jo më shumë se 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë/ha, për sipërfaqe jo më shumë se 5 ha;	1,220
19.	Projekte për sistemet e automatizimit të kontrollit në serra, për eficientë e energjisë dhe/ose për instalimin e sensorëve të kontrollit të klimës në serra, jo më shumë se 500 000 (pesëqind mijë) lekë/ha.	4,350
20.	Ambiente grumbullimi dhe ruajtëse frigoriferike për fruta perime dhe prodhime peshkore (përfshirë dhe akuakulturën), jo më shumë se 20 000 000 (njëzet milionë) lekë për një subjekt;	87,000

21.	Ambiente grumbullimi për fruta dhe perime, jo më shumë se 10 000 000 (dhjetë milion) lekë për një subjekt;	43,500
22.	Linja përpunimi/makineri pajisje për fruta – perime, vaj ulliri dhe verë jo më shumë se 20 000 000 (njëzet milion) lekë për një subjekt;	95,700
23.	Linja seleksionimi, paketimi, pastrimi, përfshirë dhe ambalazhe për fruta, perime dhe bimë medicinale dhe aromatike, jo më shumë se 5 000 000 (pesë milion) lekë për një subjekt;	26,750
24.	Linja për filetimin, tharjen, tymosjen e produkteve peshkore nga liqenet, jo më shumë se 3 000 000 (tre milion) lekë nga Organizatat e Menaxhimit të Peshkimit.	3,000
25.	Implementimi dhe certifikimi Global GAP në masën 50% të vlerës totale të faturës tatimore, jo më shumë 175 000 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë, për secilën nga produktet e përfshira në masat 1-12 si dhe për lakrën, lulëlakrën dhe brokolin për sipërfaqe të mbjellë, por jo më pak se 1 ha;	6,090
26.	Për standardet IFS (Standardi Ndërkombëtar i Ushqimit), BRC (Konsorciumi Britanik i Shitjes me Pakicë) dhe/ose FS (Miqhtë e Detit) në stabilimentet e përpunimit të prodhimeve peshkore në masën 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 325 000 (treqind e njëzet e pesë mijë) lekë për standard për produkt;	2,827
27.	Fermt organike, për periudhën në kalim, vitin e parë në vlerën 100,000 (njëqindmijë) lekë, në vitin e dytë 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë dhe 200,000 (dyqind mijë) lekë për fermë të certifikuar;	3,480
28.	Për implementimin dhe certifikimin për standardin ISO 22000:2005 për operatorët e biznesit ushqimor, në masën 50% të vlerës totale të faturës tatimore, por jo më shumë se 120 000 (njëqind e njëzet mijë) lekë;	1,044
29.	Për primin vjetor të siguracionit të prodhimeve bujqësore në masën 50% të vlerës, por primi të mos kalojë vlerën 4% të totalit të aseteve të siguruar.	5,872
30.	Për krerë të lindur të matrikulluar, për fermt me mbi 100 krerë dele dhe/ose dhi në vlerën 500 (pesëqind) lekë/krerë dhe për fermt me mbi 10 krerë lopë në vlerën 2 000 (dymijë) lekë/krerë;	243,600
31.	Për enë të certifikuar për transportin e qumështit nga ferma në pikat e grumbullimit dhe përpunimit deri në 70% të vlerës për njësi, por jo më shumë se 2 500 (dymijë e pesëqind) lekë/njësi.	82,215
32.	Ndërtimin e thertoreve, ambienteve të përpunimit të produkteve blegtorale dhe pajisjeve të nevojshme në to, jo më shumë se 20 000 000 (njëzet milion) lekë, dhe për rikonstruksion/pajisje në thertoret ekzistuese për plotësimin e standardeve të legjislacionit në fuqi, jo më shumë se 10 000 000 (dhjetë milion) lekë.	156,600
33.	Ndërtimin e pikave të reja të grumbullimit të qumështit dhe pajisjeve të nevojshme në to, jo më shumë se 3 000 000 (tre milion) lekë.	54,375
34.	Ndërtimin e ambienteve për mbarështimin e kafshëve, stabilimenteve për	68,147

	rritjen e shpendëve si dhe makineri dhe pajisje për mekanizimin dhe modernizimin e proceseve të punës në fermat blegtorale me jo më pak se 10 lopë , jo më pak se 100 të imta, jo me pak se 10 dosa dhe me kapacitet jo më pak se 10 000 shpendë por jo më shumë se 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milion) lekë.	
35.	Sisteme ftohëse të qumështit për pikat e grumbullimit dhe/ose përpunimit, jo më shumë se 1 000 000 (një milion) lekë.	21750
36.	Përmirësim të infrastrukturës së tregjeve të kafshëve, jo më shumë se 4 000 000 (katër milion) lekë për treg.	17400
37.	Mbështetje për dorëzimin e qumështit lëndë e parë, që plotëson standardet në fuqi, në vlerën 10 lekë për litër në pikat e përpunimit, për fermat me mbi 15 krerë lopë kundrejt faturës tatimore të shitjes dhe raport analizës laboratorike përkatëse.	87000
38.	Mbështetje me 1 000 (njëmijë) lekë për koshere, për ferma me jo më pak se 100 koshere bletë dhe masa e financimit të jetë jo më shumë se 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.	43391
39.	Mbështetje e pronarëve të anijeve të peshkimit dhe/ose Organizatave të Menaxhimit të Peshkimit deri në 85 000 (tetëdhjetë e pesë mijë) lekë për njësi, sipas faturës tatimore, për sistemet e monitorimit të anijes për pajisjet MTU (Njësi Transmetuese të Sinjalit) të instaluar në bordin e anijeve të peshkimit, për identifikimin dhe lokalizimin e anijeve nëpërmjet satelitit.	22185
40.	Mbështetje deri në 70% të vlerës, por jo më shumë se 20 000 000 (njëzet milion) lekë për instalimin e bankinave lundruese prej betoni, nga Organizatat e Menaxhimit të Peshkimit.	20 000
41.	Mbështetje për pikat e grumbullimit dhe fermerët për vlerën e fidanëve të domates, specit, kastravecit dhe bostanorëve të shitur ndaj fermerëve, deri në 50% të vlerës së faturës tatimore, por jo më shumë se 12 (dymbëdhjetë) lekë për fidan. Pika e grumbullimit i paguan fermerit jo më pak se 50% të vlerës së subvencionuar të fidanit. Pagesa për 50% të vlerës së fidanit, por jo më shumë se 12 lekë, ndaj grumbulluesit të kryhet kundrejt faturës tatimore dhe kontratës noteriale të lidhur me fermerët. Pagesa të kryhet kur grumbulluesi auto-faturon fermerin për prodhimin e blerë dhe konfirmon pagesën ndaj fermerit.	125280
42.	Mbështetje, në vlerën 20 (njëzet) lekë/kg për açuge dhe sardele të peshkuara, ndaj anijeve të peshkimit. Pagesa të kryhet kundrejt sasive të tregtuara në stabilimentet shqiptare të përpunimit të këtyre produkteve, të vërtetuara me fatura tatimore përfshirë vlerën e TVSH. Në rastin kur anijet janë në pronësi ose të marra me qira nga stabilimentet e përpunimit të peshkut, pagesa të kryhet kundrejt sasive të verifikuara me certifikatë zënie dhe faturave të shitjes të produkteve të zëna.	40,000

43.	Për fermerët/subjektet që kultivojnë jo më pak se 5 ha tokë bujqësore, në pronësi private ose të marrë me qira nga fermerë të tjerë që e kanë tokën në pronësi private, mbështetja për grurin dhe elbin në vlerën 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë/ha, ndërsa për thekrën, tërshërën dhe koçkullën në vlerën 20 000 (njëzet mijë) lekë/ha.	30450
44.	Mbështetje për ngritjen ose rikonstruksionin e ambienteve për veprimtari të turizmit rural nga 6 deri në 10 dhoma, në 50% të vlerës totale të faturave tatimore por jo më shumë se 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë;	32625
45.	Mbështetje për investime në agroturizëm kundrejt planit të biznesit, në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 20 000 000 (njëzet milion) lekë.	121800
46.	Mbështetje për ngritjen ose rikonstruksionin e ambienteve të prodhimit të produkteve tradicionale të zonës, në 50% të vlerës totale të faturave tatimore por jo më shumë se 1 000 000 (një milion) lekë.	4350
47.	Mbështetje për makineri dhe pajisje për prodhimin e produkteve tradicionale të zonës deri në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 500 000 (pesëqind mijë) lekë.	5 000
48.	Mbështetje për marketingun (përfshirë linjat e ambalazhim/paketimit) e produkteve tradicionale të zonës, në 70% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 700 000 (shtatëqind mijë) lekë.	12400
49.	Mbështetje për çdo sipërmarrje të re (start-up) nga individë të moshës nga 22 deri në 35 vjeç, në 50% të vlerës totale të faturave tatimore por jo më shumë se 500 000 (pesëqind mijë) lekë.	8700
50.	Mbështetje për përmirësimin e kushteve në stane për bagëtitë e imta (rikonstruksion dhe pajisje me panele fotovoltaike), në 80% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 200 000 (dyqind mijë) lekë.	8700
51.	Mbështetje për ngritjen e inkubatorëve të prodhimit të produkteve tradicionale të zonës, në 70% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milion) lekë, kundrejt planit të biznesit.	65250
52.	Mbështetje në rrjetin e subjekteve të shitjes me pakicë të produkteve ushqimore të prodhuara në vend, kundrejt planit të biznesit, në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 2 000 000 (dy milion) lekë.	21750

I. KUPTIMI I SHKURTIMEVE

MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
AZHBR	Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (Agjencia e Pagesave)
DB	Drejtoria e Bujqësisë
ZBRR	Zyra e Bujqësisë në Rreth
ZRPP	Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme
DPAP	Drejtoria e Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteve, AZHBR
DK	Drejtoria e Kontrollit, AZHBR
ESHFF	Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve
INSTAT	Instituti i Statistikave
DAP	Drejtoria e Autorizimit të Pagesave në AZHBR
DEP	Drejtoria e Ekzekutimit të Pagesave në AZHBR
DAMT	Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në qark
SPAP	Spektori i Përzgjedhjes dhe Aprovimit të projekteve në AZHBR
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
NIPT	Numri i Identifikimit i Personit të Tatuashëm
NUIS	Numri i Identifikimit të Subjektit
AKU	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
SHBB	Shoqëri e Bashkëpunimit Bujqësor
OJF	Organizatë Jo-Fitimprurëse
OMP	Organizatë e Menaxhimit të Peshkimit
AKZM	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura

II. KRITERE TË PËRGJITHSHME TË PËRFITIMIT

1. Aplikuesit duhet të jenë shtetas shqiptarë, ose kompani me bashkëpronësi, njëri nga të cilët të jetë shqiptar;
2. Përfitues sipas masave mbështetëse mund të jenë fermerë individualë, grup fermerësh, subjekte me status fizik, juridik, SHBB, OMP ose OJF;
3. Fermerët individualë, të jenë të pajisur me NIPT-in e fermerit;
4. SHBB-të, OMP-të dhe personat fizik dhe juridik të jenë të pajisur me NIPT/NUIS;
5. Ekstrakti i regjistrimit në QKB;
6. Mbështetja financiare për masat mbështetëse të jetë sipas hartës bujqësore në Aneksin 1, dhe përcaktimeve në këtë udhëzim;
7. Përfituesit nuk duhet të jenë debitor ndaj AZHBR apo MBZHR;
8. Përfituesit (persona fizikë dhe juridikë), nuk duhet jetë debitorë për tatim-taksat;
9. Nga masat mbështetëse mund të përfitojë vetëm një pjesëtar i familjes aplikuese, referuar certifikatës familjare me statusin në momentin e aplikimit;
10. Aplikuesit mund të aplikojnë dhe përfitojnë deri në 3 masa mbështetëse, brenda grupmasave të përcaktuara në Aneksin 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi, por jo më shumë se 30 milion lekë;
11. Përfituesi të ketë bërë “shlyerjen koherente të sigurimeve shoqërore”;
12. Për ofertat në valutë të huaj do të zbatohet kursi i këmbimit të Bankës së Shqipërisë në ditën e hapjes së aplikimit;
13. Për masat mbështetëse direkte faturat/aktet e zhdoganimit, duhet të jenë pas datës 01/01/2018, por para datës së verifikimit në terren;
14. Për masat mbështetëse të investimeve me nr. 12, 20-24, 32-36, 40 dhe 44-52, punimet dhe faturat/aktet e zhdoganimit duhet të jenë pas datës së lidhjes së kontratës;
15. Të gjitha linjat, makineritë dhe pajisjet të jenë të reja;
16. Për masat mbështetëse të investimeve në rastin e ndërtimeve/rikonstruksioneve aplikuesi duhet të ketë lejen përkatëse të ndërtimit sipas legjislacionit në fuqi, para lidhjes së kontratës;
17. Për investimet ku masa e financimit është me vlerë mbi 10 milion lekë, investimi përkatës të jetë i siguruar të paktën deri në vlerën e financimit nga AZHBR, dhe ky kusht parashikohet në kontratën e lidhur me subjektin përfitues;
18. Financimi i shumës së përfituar bëhet në bankat e nivelit të dytë;
19. I gjithë dokumentacioni i kërkuar të jetë në gjuhën shqipe ose në rast se është në gjuhë të huaj të jetë i përkthyer nga një përkthyes i autorizuar.

Kriteret e përcaktuara në pikat 1-10, të këtij kreu, vërtetohen nga sistemi e-Albania ose nga sistemi i AZHBR-së në momentin e aplikimit.

Aplikuesi me statusin fermer ose person fizik dhe juridik, që kryen aktivitetet për prodhimin bujqësor dhe blegtoral, para se fillojë procedurën e aplikimit, duhet plotësojë formularin e regjistrimit të fermës.

Për plotësimin e regjistrimit të fermës, aplikuesi të ketë informacionin e nevojshëm për të dhënat e përcaktuara në Aneksin 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

III. APLIKIMI

Informacioni për mënyrën e aplikimit, kriteret e përfitimit dhe procedimit deri në përfitimin e mbështetjes financiare gjendet pranë Agropikave, pranë Drejtorive të Bujqësisë, Zyrave Rajonale dhe Qendrore të AZHBR si dhe në faqen e saj të internetit: www.azhbr.gov.al

Aplikimet do të bëhen nga **data 28.02.2018 deri më 28.03.2018**.

1. Aplikimi on-line

- a. Aplikimet për masat mbështetëse direkte me nr. 1-11, 13-19, 25-29, 30-31, 37-38, 41-43, do të bëhet online;
- b. Përfitues për masat mbështetëse të mësipërme mund të jenë fermerë individualë, grup fermerësh, subjekte me status fizik, juridik, SHBB dhe OMP;
- c. Aplikimi on-line bëhet mbi bazën e parimit “zero dokumente” në momentin e aplikimit;
- d. Aplikimi on-line do të bëhet pranë Agropikave dhe 31 zyrave të Drejtorive të Bujqësisë/zyrave rajonale të AZHBR-së. Lista e zyrave të aplikimit jepet në Aneksin 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi;
- e. Aplikimi on line do të bëhet me asistencë nga inspektorët e AZHBR dhe specialistët e DB-ve;
- f. Gjatë periudhës së aplikimit sportelet e pranimit të aplikimeve pranë agropikave apo zyrave rajonale të AZHBR/DB do të qëndrojnë të hapura nga ora 8:00 deri në 16:00. Nëse në orën 16:00 ka aplikues në zyrat e aplikimit, sportelet do të qëndrojnë të hapura deri në përfundim të të gjithë aplikuesve, që kanë qenë prezent në orën 16:00;
- g. Për qëllime identifikimi, aplikuesi sipas statusit përkatës (fermer/ person fizik/ juridik, SHBB, OMP) duhet të paraqitet në sportelin e aplikimit me kartë identiteti/pasaportë biometrike;
- h. Në rastin kur aplikuesi është me status fermer, krahas kartës identiteti/pasaportë biometrike duhet të ketë NIPT aktiv dhe të disponojë informacionin e nevojshëm për plotësimin e regjistrit të fermës;
- i. Në çdo zyrë aplikimi, specialisti i ekstensionit bujqësor asiston aplikuesit me këshilla dhe informacionin e nevojshëm;
- j. Mënyra e futjes në sistem, plotësimi i regjistrit të fermës dhe plotësimi i aplikimit sipas masës mbështetëse përshkruhet në manualin e përgatitur nga AKSHI.
- k. Të gjithë aplikuesit me status fermer ose person fizik dhe juridik, që kryen aktivitet për prodhimin bujqësor dhe blegtoral, para aplikimit duhet të plotësojnë regjistrin e fermës.
- l. Me plotësimin e regjistrit të fermës, fillon aplikimi për masën përkatëse.

2. Aplikimi me dosje në AZHBR

- a. Aplikimet për masat mbështetëse të investimeve me nr 12, 20-24, 32-36, 40 dhe 44-52, do të bëhen me dosje në zyrat qendrore të AZHBR;

- b. Për qëllime identifikimi, aplikuesi sipas statusit përkatës (fermer/ person fizik/ juridik, SHBB, OMP dhe OJF) duhet të paraqitet në zyrat qendrore të AZHBR-së me kartë identiteti/pasaportë biometrike;
- c. Nëse për masa mbështetëse të veçanta të investimeve, aplikuesit kanë statusin fermer ose person fizik dhe juridik, që kryen aktivitet për prodhimin bujqësor dhe blegtoral, ata duhet të kenë plotësuar formularin e regjistrimit të fermës në zyrat qendrore të AZHBR-së.

IV. DOKUMENTACIONI QË GJENEROHET NGA REGJISTRAT ZYRTARË DHE QË SIGUROHET NGA AZHBR

1. Formulari i aplikimit për masën mbështetëse perkatëse. Varianti i printuar i formularit të aplikimit, firmoset nga aplikuesi dhe përfaqësuesi i AZHBR;
2. Të dhënat e kartës së identitetit të aplikuesit;
3. Certifikata familjare me statusin në momentin e aplikimit;
4. Dokumenti që vërteton statusin e aplikuesit (fermer, person fizik/juridik, SHBB);
5. Konfirmimi që aplikuesi dhe familjarët e tij nuk janë debitor ndaj AZHBR apo MBZHR;
6. Vërtetimi për “shlyerjen koherente të sigurimeve shoqërore” (pas përfshirjes së aplikuesit në listën paraprake të fituesve);
7. Vërtetimi për shlyerjen e tatimeve dhe taksave për personat fizikë dhe juridikë;
8. Leje apo licenca për masat perkatëse, sipas legjislacionit në fuqi;
9. Rregjistri elektronik i blegtorisë dhe bletarisë.

Nëse ndonjë dokument nuk arrihet të gjenerohet nga regjistrat zyrtarë, aplikuesit informohen zyrtarisht dhe u lihet një afat 10 ditë pune për plotësimin dhe dorëzimin e tyre zyrtar në AZHBR. Dorëzimi jo i plotë i dokumenteve të kërkuar apo përtej afatit të përcaktuar, është kriter skualifikimi.

V. KRITERET SPECIFIKE DHE DOKUMENTACIONI PËR MASAT MBËSHTETËSE DIREKTE ME NR. 1-11, 13-19, 25-29, 30-31, 37-38, 41-43

1. Dokumentacioni që dorëzohet nga aplikuesi, pas përfshirjes në listën paraprake të fituesve

- a. Dokumentin e dakortësisë së anëtarëve të SHBB, grup fermerëve apo ortakëve të subjektit para noterit për masën mbështetëse që aplikon;
- b. Vërtetimin e bankës për numrin e llogarisë bankare;
- c. Projektin për mbjelljen e drufrutoreve për masat 1-6, 8 dhe 9 sipas formularit në Aneksin 5, për masën 7 sipas formularit në Aneksin 5/1 dhe projektet për masat 13, 14, 17 dhe 19, sipas formularëve të Anekseve përkatës 6, 7, 8, 9;
- d. Plan vendosjen e serrës për zëvendësimin e plastmasit, ku të përcaktohet orientimi, përmasat e serrës dhe sipërfaqja e serrës (masa 15), sipas formularit të Aneksit 10;
- e. Kontratën me trupën certifikuese të akredituar për certifikimin përkatës të produkteve për masat 25, 26, 27 dhe 28;
- f. Dokumentacionin e pronësisë së tokës (për masat 1-11, 13-19, 25, 27, 29, 41, 43):
Pronësia mbi tokën bujqësore, vërtetohet me një nga dokumentat e mëposhtëm:
 - Çertifikatë pronësie, e shoqëruar me hartën treguese dhe kartelën e pasurisë së paluajtshme, kjo e fundit e rifreskuar jo më herët se 3 muaj para aplikimit (për zonat ku ka përfunduar regjistrimi fillestar i tokës);
 - Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP), sipas legjislacionit për ndarjen e tokës bujqësore, bashkëlidhur me fragmentin e hartës kadastrale, të vërtetuar nga DAMT ose Njësia Administrative ku ndodhet ngastra.Në të dy rastet, kur aplikuesi është një nga anëtarët e familjes bujqësore dhe pronësia i takon familjes bujqësore, është e nevojshme dakorësia para noterit e të gjithë bashkëpronarëve të familjes bujqësore.

Kur aplikuesi mer tokë me qira:

- Kontratë qiraje me akt noterial, me individë ose subjekte, që e kanë tokën bujqësore në pronësi. Afati i qiradhënies të jetë jo më pak se pesë vjet, në rastin e kulturave drufrutore dhe jo më pak se një vit për kulturat një vjeçare;
 - Kontrata e qirasë për pasuritë e paluajtshme me natyrë bujqësore për një periudhë mbi nëntë vjet, akti noterial regjistrohet në regjistrin publik të ZVRPP. Në këtë rast duhet të paraqitet kartela e pasurisë ku është pasqyruar kontrata e qirasë.
- g. Kontratën midis përfituesit dhe kompanive që ofrojnë shërbimin e kërkuar për masat 29 dhe 41, kurse për masën 31 aplikuesi paraqet listën e fermerëve, që përdorin enët e transportit të qumështit.

2. Kriteret dhe dokumentacioni specifik që sigurohet nga aplikuesit, pas përfshirjes në listën paraprake të fituesve dhe në verifikim

Masat 1-11: Mbjellje të reja të drufrutoreve dhe bimëve aromatike dhe medicinale

i. Kritere specifike të përfitimit

Përfituesit e mundshëm: Fermerë, grup fermerësh, SHBB, person fizik ose juridik.

- a. Sipërfaqja e mbjellë të jetë jo më e madhe se 20 ha, sipas kategorive të mëposhtme:
 - për fermerët individual jo më pak se 0.5 ha në një bllok të vetëm dhe jo më pak se 0.3 ha, kur i bashkëngjitet blloqeve ekzistuese;
 - për grup fermerësh jo më pak se 1 ha, në një bllok të vetëm;
 - për Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor (SHBB) jo më pak se 5 ha, ndërsa madhësia e ngastrës të jetë, jo më pak se 0.3 ha, kur nuk është në bllok.
- b. Mbështetja financiare të bëhet për kultivarët e përcaktuar në Aneksin 11, bashkëlidhur këtij udhëzimi;
- c. Materiali mbjellës dhe shumëzues bimor të jetë i certifikuar;
- d. Numri minimal i bimëve për ha për mbjelljet e reja sipas specieve, të jetë sipas Aneksit 12 bashkëlidhur, këtij udhëzimi;
- e. Toka të jetë në pronësi të aplikuesit dhe/ose me qira për të paktën 5 vjet përfshirë edhe vitin e aplikimit;
- f. Të realizojnë mbjelljet brenda 6-mujorit të parë të vitit 2018. Faturat e blerjes së materialit mbjellës duhet të përputhen me periudhën e realizimit të mbjelljeve.

ii. Dokumentacioni specifik, që dorëzohet nga aplikuesi, pas përfshirjes në listën paraprake të fituesve

- a. Dokumenti i dakortësisë së anëtarëve të grup fermerëve, SHBB apo ortakëve të subjektit para noterit, për objektin që aplikon;
- b. Dokumentacionin e pronësisë së tokës apo marrjes me qira;
- c. Vërtetimin e bankës për numrin e llogarisë bankare.

iii. Dokumentacioni i dorëzuar në momentin e verifikimit

- a. Për farat dhe fidanët e prodhuar në vend:
 - Faturë tatimore e blerjes së fidanëve/farave, lëshuar nga subjekti tregtues, ku specifikohet lloji dhe sasia e farave/fidanëve të blerë, si dhe seria e fidanëve të tregtuar sipas certifikatës;
 - Një fotokopje të certifikatës zyrtare për materialin mbjellës (lëshuar nga ESHFF), nga subjekti i certifikuar me nënshkrim e vulë të njomë të subjektit tregtues.
- b. Për materialin mbjellës të importuar (farat dhe fidanët):
 - Faturën tatimore të blerjes lëshuar nga subjekti tregtues ose aktin e zhdoganimit, ku specifikohet specia, kultivari dhe sasia e materialit mbjellës të blerë;
 - Fotokopje të certifikatës së origjinës/certifikatës fitosanitare/certifikatës nga AKU, të vërtetuar me origjinalen me nënshkrimin dhe vulën e njomë të subjektit tregtues;

Masat 13-19: Përmirësimi i teknologjive të kultivimit dhe inovacione

i. Kriteret specifike të përfitimit

Masa 13: Përmirësimi i teknikave të ujitjes nëpërmjet instalimit të ujitjes me pika

Përfituesit e mundshëm: Fermerë individualë, grup fermerësh, SHBB, person fizik ose juridik;

- a. Speciet që parashikohen të mbështeten për këtë masë të kenë numrin minimal të bimëve për njësi sipërfaqe në përputhje me Aneksin 12 dhe 12/1, bashkëlidhur këtij udhëzimi;
- b. Aplikuesi mund të bëjë vetëm një aplikim edhe kur i referohet disa specieve frutore, por toka për të cilën aplikohet të jetë një parcelë/bllok dhe mënyra e kultivimit të të gjitha specieve të jetë intensive;
- c. Tubacioni kryesor i furnizimit me ujë të sistemit shpërndarës të jetë i vendosur nëntokë;
- d. Të gjithë elementët e sistemit të ujitjes me pika të jenë të reja dhe të shprehura në faturë, në përputhje me projektin;
- e. Toka të jetë në pronësi të aplikuesit dhe/ose me qira për të paktën 5 vjet nga viti i aplikimit.

Masa 14: Instalimi i sistemit të ngrohjes me biomasë (pelet) në serrat me ngrohje

Përfituesit e mundshëm: Fermer individual, person fizik ose juridik

- a. Aplikuesi për instalimin e sistemit të ngrohjes me biomasë (pelet) në serrat me ngrohje, të ketë projektin përkatës, sipas formularit të Aneksit 7, bashkëlidhur këtij udhëzimi;
- b. Elementët e sistemit të ngrohjes me biomasë të jenë të reja dhe në përputhje me projektin;
- c. Toka të jetë në pronësi të aplikuesit dhe/ose me qira për të paktën 5 vjet nga viti i aplikimit.

Masa 15: Për zëvendësimin e plastmasit termik për serrat diellore ekzistuese

Përfituesit e mundshëm: Fermerë individual, person fizik ose juridik

- a. Përfituesi të kësaj mase janë fermerë, të cilët kanë serra me ngrohje diellore me plasmas me destinacion prodhimin e perimeve si domate, kastravec dhe spec;
- b. Aplikuesi që përfiton financim për këtë masë mbështetje nuk mund të aplikojë nëse në 3 vitet e fundit ka përfituar nga e njëjta masë mbështetëse, për të njëjtën serrë; ky kufizim vlen dhe nëse ndryshon aplikuesi, por është e njëjta serrë;
- c. Plastmasi të jetë termik, i tipit “long life”, i vërtetuar me certifikatën e garancisë;
- d. Aplikuesi të ketë planvendosjes e serrës për zëvendësimin e plastmasit, sipas formularit të Aneksit 10;
- e. Toka të jetë në pronësi të aplikuesit dhe/ose me qira për të paktën 5 vjet nga viti i aplikimit.

Masa 16: Prodhimi i bostanoreve në tunele (mulçerimi dhe mbulimi me plastmas termik)

Përfituesit e mundshëm: Fermerë individual, grup fermerësh, SHBB, person fizik ose juridik;

- a. Aplikuesi për prodhimin e bostanoreve (shalqi, pjepër) në tunele (mulçerimin dhe mbulimin me plastmas termik), duhet të ketë numrin e bimëve për ha, sipas aneksit 12/1, bashkëlidhur këtij udhëzimi;
- b. Plastmasi të jetë i ri, termik, i vërtetuar me certifikatën e garancisë;
- c. Toka të jetë në pronësi të aplikuesit dhe/ose me qira për të paktën 1 vit.

Masa 17: Rrjeta për mbrojtjen e prodhimit nga breshëri në blloqet ekzistuese të kulturës së mollës dhe qershisë

Përfituesit e mundshëm: Fermerë individual, grup fermerësh, SHBB, person fizik ose juridik;

- a. Aplikuesi për rrjeta për mbrojtjen e prodhimit nga breshëri në blloqet ekzistuese të kulturës së mollës dhe qershisë, duhet të ketë projektin përkatës, sipas formularit të Aneksit 8, bashkëlidhur këtij udhëzimi;

- b. Rrjeta të jetë e shoqëruar me certifikatën e garancisë;
- c. Të gjithë elementët e sistemit të mbrojtjes nga breshëri të jenë të rinj dhe në përputhje me projektin;
- d. Toka të jetë në pronësi të aplikuesit dhe/ose me qira për të paktën 5 vjet nga viti i aplikimit;

Masa 18: Polenizimi i kulturave perimore në serra me bletë polenizuese, jo mjaltëdhënëse

Përfituesit e mundshëm: Fermerë individual, grup fermerësh, SHBB, person fizik ose juridik;

- a. Aplikuesi të vendosë numrin optimal të koshereve për polenizimin e kulturave perimore në serra me bletë polenizuese, jo mjaltëdhënëse (e përlllogaritur 7 koshere për një ha serrë);
- b. Kosheret që do të vendosen duhet të jenë me bletë polenizuese, jo mjaltëdhënëse të vërtetuar me certifikatën përkatëse;
- c. Toka ku do të vendosen kosheret të jetë në pronësi të aplikuesit dhe/ose me qira për vitin e aplikimit.

Masa 19: Projekte për sistemet e automatizimit të kontrollit në serra, për efikasitetin e energjisë dhe/ose për instalimin e sensorëve të kontrollit të klimës në serra

Përfituesit e mundshëm: Fermerë individual, person fizik ose juridik;

- a. Aplikuesi për sistemet e automatizimit të kontrollit në serra, për efikasitetin e energjisë dhe/ose për instalimin e sensoreve të kontrollit të klimës në serra, të ketë projektin me specifikimet përkatëse, sipas formularit në Aneksin 9;
- b. Të gjithë elementët e sistemit të automatizimit të kontrollit në serra të jenë të rinj dhe në përputhje me projektin;
- c. Toka të jetë në pronësi të aplikuesit dhe/ose me qira për të paktën 5 vjet nga viti i aplikimit;

ii. Dokumentacioni që dorëzohet nga aplikuesi, pas përfshirjes në listën paraprake të fituesve (për masat 13-19)

- a. Planvendosjen e serrës, ku të përcaktohen përmasat dhe sipërfaqja e serrës, për të cilën kërkohet të zëvendësohet plasmasi (Masa 15);
- b. Projektin për masat 13, 14, 15, 17 dhe 19, sipas formularëve të Anekseve përkatëse;
- c. Marrëveshje e dakortësisë së anëtarëve të grup fermerëve, SHBB apo ortakëve të subjektit para noterit, për objektin që aplikon;
- d. Dokumentacionin e pronësisë/qirasë së tokës;
- e. Vërtetimin e bankës për numrin e llogarisë bankare.

iii. Dokumentacioni i dorëzuar në momentin e verifikimit (Për masat mbështetëse 13-19)

- a. Fatura/faturat tatimore të blerjeve përkatëse, të detajuar me vlerën e elementëve përbërës, shoqëruar me specifikimet teknike dhe certifikatën e garancisë;
- b. Akt zhdoganimit për rastet kur materialet vijnë nga jashtë vendit, shoqëruar me specifikimet teknike dhe vlerën e elementëve përbërës.
- c. Zërat e faturës tatimore duhet të përputhen me specifikimet teknike të deklaruara;
- d. Faturat e mësipërme duhet të jenë të shoqëruara me kuponin e kasës fiskale ose mandat pagesën e bankës;

Masat 25-29: Certifikimi dhe mbrojtja e prodhimeve bujqësore

Masa 25: Implementimi dhe certifikimi Global GAP

i. Kriteret specifike të përfitimit

Përfituesit e mundshëm: Fermerë individual, grup fermerësh, SHBB, person fizik ose juridik;

- a. Përfitojnë mbështetje financiare aplikuesit që certifikojnë sipas Global GAP, produktet e specive të përfshira në masat mbështetëse 1-12 të këtij udhëzimi si dhe lakrën, lulëlakrën dhe brokolin;
- b. Një aplikues mund të përfitojë një certifikatë e cila mund të përmbajë më shumë se një produkt;
- c. Aplikuesi duhet të jetë në procedurë certifikimi me një trupë certifikimi të akredituar (shqiptare ose e huaj);
- d. Certifikata të ketë elementë të verifikueshëm on line, për operatorin, trupën e certifikimit dhe organizmin akreditues në faqen zyrtare të GLOBAL GAP;
- e. Aplikuesit të ndjekin procedurën e miratuar deri në marrjen e certifikatës Global GAP.

ii. Dokumentacioni që dorëzohet nga aplikuesi, pas përfshirjes në listën paraprake të fituesve

- a. Kontrata e lidhur nga aplikuesi me trupën e certifikimit të akredituar;
- b. Dokumenti i dakortësisë së anëtarëve të grup fermerëve, SHBB apo ortakëve të subjektit para noterit, për produktin që aplikon;
- c. Dokumentacionin e pronësisë së tokës apo marrjes me qira;
- d. Vërtetimin e bankës për numrin e llogarisë bankare.

iii. Dokumentacioni i dorëzuar në momentin e verifikimit

- a. Certifikatë origjinale që vërteton sasinë e prodhimit të certifikuar si Global GAP për herë të parë, të lëshuar nga trupa e certifikimit e akredituar;
- b. Faturë tatimore për kostot e procesit të implementimit;
- c. Faturë tatimore nga trupa e certifikimit e akredituar /ose invoice kur trupa e certifikimit nuk është kompani shqiptare;
- d. Transferten e bankës/kuponi tatimor për faturat e mësipërme nga subjekti që është certifikuar;

Masa 26: Për standardet IFS (Standarti Ndërkombëtar i Ushqimit), BRC (Konsorciumi Britanik i Shitjes me Pakicë) dhe/ose FS (Miqhtë e Detit) në stabilimentet e përpunimit të prodhimeve peshkore

i. Kriteret specifike të përfitimit

Përfituesit e mundshëm: Person fizik ose juridik;

- a. Aplikuesi të ketë licencë për aktivitetin që zhvillon;
- b. Përfitojnë mbështetje financiare aplikuesit që janë në procedurë certifikimi për produktet e tyre për standardet IFS, BRC dhe/ose FS, nga një trupë certifikimi e akredituar (shqiptare ose e huaj);
- c. Stabilimentet ose fabrikat e përpunimit të jenë të pajisur me numër CEE për import-eksport;
- d. Certifikata të ketë elementë të verifikueshëm on line, për operatorin, trupën e certifikimit dhe organizmin akreditues.

ii. Dokumentacioni që dorëzohet nga aplikuesi, pas përfshirjes në listën paraprake të fituesve

- a. Kontrata e lidhur nga aplikuesi me trupën certifikuese të akredituar për certifikimin e produkteve për standardet IFS, BRC dhe/ose FS në stabilimentet e prodhimit të produkteve peshkore;

- b. Vërtetimin që stabilimenti ose fabrika e përpunimit është e pajisur me numër CEE për import-eksport;
- c. Leje ose licencë për aktivitetin, sipas legjislacionit në fuqi;
- d. Vërtetimin e bankës për numrin e llogarisë bankare.

iii. Dokumentacioni i dorëzuar në momentin e verifikimit

- a. Certifikatë origjinale të lëshuar nga një trupë certifikimi e akredituar për certifikimin e produkteve për standardet IFS, BRC dhe/ose FS;
- b. Faturë tatimore të subjektit certifikues/ose invoice kur subjekti nuk është kompani shqiptare;
- c. Transfertën bankare të subjektit që është certifikuar me vlerën e shërbimit.

Masa 27: Fermat organike, për periudhën në kalim, vitin e parë, i dytë dhe për fermë e certifikuar.

i. Kritere specifike të përfitimit

Përfituesit e mundshëm: Fermerë individual, SHBB, grup fermerësh, person fizik ose juridik;

- a. Përfitojnë të gjithë aplikuesit që janë në sistem/skeme certifikimi, në kalim (viti parë dhe /ose viti i dytë) ose në certifikim, me kusht që sipërfaqja e një specie të mos jetë më e vogël se 0.5 ha;
- b. Toka të jetë në pronësi të aplikuesit, në përdorim ose me qira për të paktën 5 vjet nga viti i aplikimit.

ii. Dokumentacioni që dorëzohet nga aplikuesi, pas përfshirjes në listën paraprake të fituesve

- a. Kontrata e lidhur nga aplikuesi me një trupë kontrolli të miratuar në MBZHR për specien/speciet dhe sipërfaqen e kultivuar;
- b. Dokumenti i dakortësisë së anëtarëve të grup fermerëve, SHBB apo ortakëve të subjektit para noterit, për objektin që aplikon;
- c. Dokumentacionin e pronësisë së tokës, në rastet kur nuk shfaqet nga sistemi;
- d. Vërtetimin e bankës për numrin e llogarisë bankare;

iii. Dokumentacioni i dorëzuar në momentin e verifikimit

- a. Dokumentat e certifikimit (certifikatë për statusin e certifikimit, anekset e certifikatës, listën e parcelave me sipërfaqe dhe sasinë e prodhimeve) lëshuar nga një trupë kontrolli e miratuar nga MBZHR;
- b. Faturë tatimore të trupës certifikuese/ose invoice kur nuk është kompani shqiptare;
- c. Transferte e bankës të subjektit që është certifikuar me vlerën e shërbimit;

Masa 28: Për implementimin dhe certifikimin për standardin ISO 22000:2005 për linjat e përpunimit

i. Kritere specifike të përfitimit

Përfituesit e mundshëm: Person fizik ose juridik

- a. Përfitojnë operatorët ushqimorë që janë në procedurë certifikimi për standardin ISO 22000:2005;
- b. Subjekti të ketë licencat për aktivitetin që zhvillon, sipas legjislacionit në fuqi;
- c. Certifikata të ketë elementë të verifikueshëm on line, për operatorin, trupën e certifikimit dhe organizmin akreditues;

ii. Dokumentacioni që dorëzohet nga aplikuesi, pas përfshirjes në listën paraprake të fituesve

- a. Kontrata e lidhur nga aplikuesi për certifikim me standardin ISO 22000:2005, me trupën certifikuese të akredituar;
- b. Licencë për ushtrimin e aktivitetit sipas legjislacionit në fuqi;
- c. Vërtetimin e bankës për numrin e llogarisë bankare;

iii. Dokumentacioni i dorëzuar në momentin e verifikimit

- a. Vërtetim i lëshuar nga AKU, që operatori zbaton standardin e sigurisë ushqimore HACCP;
- b. Certifikatë që operatori i biznesit ushqimor implementon standardin ISO 22000:2005, lëshuar nga një trupë certifikuese e akredituar;
- c. Faturë tatimore të subjektit certifikues/ose invoice kur nuk është kompani shqiptare;
- d. Transferten e bankës të subjektit që është certifikuar;

Masa 29: Për primin vjetor të siguracionit të prodhimeve bujqësore

i. Kritere specifike të përfitimit

Përfituesit e mundshëm: Fermerë individual, grup fermerësh, SHBB, person fizik ose juridik;

- a. Të ketë lidhur kontratë sigurimi me kompani sigurimi, për prodhimin e pritshëm bujqësor për vitin 2018, objekt i kësaj kontrate;
- b. Toka të jetë në pronësi të aplikuesit, ose e marë me qira.

ii. Dokumentacioni që dorëzohet nga aplikuesi, pas përfshirjes në listën paraprake të fituesve

- a. Kontratën e lidhur me kompaninë e sigurimeve;
- b. Marrëveshjen e dakortësisë së anëtarëve të grup fermerëve, SHBB apo ortakëve të subjektit para noterit;
- c. Dokumentacionin e pronësisë së tokës apo marrjes me qira;
- d. Vërtetimin e bankës për numrin e llogarisë bankare.

iii. Dokumentacioni i dorëzuar në momentin e verifikimit

- a. Faturë me TVSH, dhe/ose primi i sigurimit kur është faturë e autorizuar nga DPT;
- b. Transferten e bankës për shumën e paguar si siguracion;

Masat 30, 31, 37: Për përmirësimin e zinxhirit të sigurisë ushqimore të produkteve blegtorale

Masa 30: Për krerë të lindur, të matrikulluar me mbi 100 krerë dele dhe/ose dhi dhe për fermat me mbi 10 krerë lopë

i. Kritere specifike të përfitimit

Përfituesit e mundshëm: Fermerë individual, SHBB, grup fermerësh, person fizik ose juridik.

- a. Aplikuesi duhet të ketë në tufën bazë jo më pak se 100 krerë dele dhe/ose dhi apo 10 krerë lopë të matrikulluara;
- b. Kafshët e tufës bazë duhet të jenë të regjistruara në sistemin e identifikimit dhe regjistrimit të kafshëve RUDA;

Për të imëtat, konsiderohen lindje të reja krerët e matrikulluar qengja dhe/ose keca të lindur në periudhës nëntor 2017 deri në prill 2018;

Për gjedhin konsiderohen lindje të reja krerët e matrikulluar, vetëm viçat, lindje të vitit 2018.

ii. Dokumentacioni që dorëzohet nga aplikuesi, pas përfshirjes në listën paraprake të fituesve

a. Vërtetimin e bankës për numrin e llogarisë bankare.

iii. Dokumentacioni i dorëzuar në momentin e verifikimit

a. Formulari i Identifikimit (Matrikullimit) për qengjat dhe kecat, i lëshuar nga Klinikat Veterinare/Veterineri Praktik i kontraktuar;

b. Në rastin e qengjave ose kecape të lindur, të cilët mund të jenë dërguar për therje/shitje duhet të paraqesë:

- Vërtetim/formular për çregjistrimin nga sistemi të qengjave/kecape të therur;
- Faturën tatimore të shitjes ose autofaturën.

c. Regjistri elektronik i matrikujve për viçat e lindur i konfirmuar nga DB përkatëse, kur nuk gjenerohet nga sistemi;

Masa 31: Për enë të certifikuara për transportin e qumështit nga ferma në pikat e grumbullimit dhe përpunimit

i. Kritere specifike të përfitimit

Përfituesit e mundshëm: Person fizik dhe juridik;

a. Aplikues janë operatorët e grumbullimit dhe/ose përpunimit të qumështit;

b. Aplikuesi të ketë leje ose licencë për aktivitetin, sipas legjislacionit në fuqi;

c. Enët për transportin e qumështit të jenë material inoksi dhe të plotësojnë kërkesat e përcaktuara në Udhëzimin nr. 5, datë 25.3.2011, “Për kërkesat specifike të higjienës për stabilimentet e prodhimit, grumbullimit dhe përpunimit të qumështit dhe produkteve me bazë qumështi”;

d. Numri i enëve të jetë i mjaftueshëm për gjithë sasinë ditore të qumështit që parashikohet të grumbullohet;

e. Enët u jepen në përdorim fermerëve, sipas sasisë së qumështit që dorëzohet prej tyre;

ii. Dokumentacioni që dorëzohet nga aplikuesi, pas përfshirjes në listën paraprake të fituesve

a. Listën e fermerëve (emri i fermerit, numri i kartës identitetit, tel., kapaciteti për enë dhe numri i nevojshëm i enëve) dhe sasi të qumështit që grumbullohen prej tyre;

b. Vërtetimin e bankës për numrin e llogarisë bankare;

iii. Dokumentacioni i dorëzuar në momentin e verifikimit

a. Certifikatën e origjinës dhe garancisë për enët e blera;

b. Faturë tatimore të blerjes së enëve të transportit të qumështit, ku të specifikohet sasia e enëve të blera dhe vlera për njësi;

c. Transfertestën e bankës të subjektit që i janë shitur enët e transportit të qumështit;

d. Listën e fermerëve (emri i fermerit, numri i kartës identitetit, tel., numri i enëve me kapacitetin përkatës që ka marë fermeri në përdorim dhe firma);

Masa 37: Mbështetje për dorëzimin e qumështit lëndë e parë, që plotëson standardet në fuqi, në vlerën 10 lekë për litër në pikat e përpunimit

i. Kritere specifike të përfitimit

Përfituesit e mundshëm: Fermerë individual, SHBB, grup fermerësh, person fizik ose juridik.

- a. Përfitojnë mbështetje financiare për dorëzimin e qumështit lëndë e parë, që plotëson standardet në fuqi, në pikat e përpunimit, aplikuesit për fermat me mbi 15 krerë lopë;
- b. Lopët të jenë të matrikulluara dhe të regjistruara në sistemin e identifikimit dhe regjistrimit të kafshëve RUDA;
- c. Sasia dhe cilësia e qumështit të dorëzuar/shitur, të jetë e konfirmuar me raport analizën laboratorike përkatëse, të kryer jo më pak se një herë në dy javë në nivel ferme dhe pa pagesë nga laboratorët rajonalë të AKU-së;
- d. Pikat e përpunimit ku dorëzohet qumështit të jenë të licencuara, sipas legjislacionit në fuqi;
- e. Mbështetja financiare kryhet për faturat tatimore të lëshuara dhe të dorëzuara në AZHBR jo më vonë se data 15/11/2018.

ii. Dokumentacioni që dorëzohet nga aplikuesi, pas përfshirjes në listën paraprake të fituesve

- a. Vërtetimin e bankës për numrin e llogarisë bankare.

iii. Dokumentacioni i dorëzuar në momentin e verifikimit

- a. Faturat tatimore për sasinë e qumështit të shitur, të shoqëruara me raport analizën laboratorike përkatëse të kryer jo më pak se një herë në dy javë në nivel ferme;
- b. Faturat tatimore të dorëzimit të qumështit të jenë sipas statusit të aplikuesit:
 - Kur aplikuesi është subjekt tatimor (fizik ose juridik) dorëzohen fatura me TVSH ose fatura të thjeshta tatimore;
 - Kur aplikuesi është fermer individual, dorëzohen fatura tatimore të lëshuar nga blerësi (autofaturë);
- c. Faturat të jenë të shoqëruara me kupon tatimor ose transfertë bankare;

Masa 38: Për mbarëshkrimin e bletarisë

i. Kritere specifike të përfitimit

Përfituesit e mundshëm: Fermerë individual, SHBB, grup fermerësh, person fizik ose juridik;

- a. Aplikuesi të ketë jo më pak se 100 koshere bletë;
- b. Kosheret e bletëve të jenë matrikulluara dhe të regjistruara në regjistrin përkatës të lëshuar nga DB;
- c. Të mos ketë më shumë se 3 vendndodhje (park bletësh) në momentin e verifikimit;
- d. Aplikuesi të deklarojë vendndodhjen e parqeve në momentin e verifikimit.

ii. Dokumentacioni që dorëzohet nga aplikuesi, pas përfshirjes në listën paraprake të fituesve

- a. Vërtetimin e bankës për numrin e llogarisë bankare;

iii. Dokumentacioni i dorëzuar në momentin e verifikimit

- Nuk ka dokumenta.

Masa 41: Mbështetje për pikat e grumbullimit dhe fermerët për vlerën e fidanëve të domates, specit, kastravecit dhe bostanorëve të shitur ndaj fermerëve

i. Kritere specifike të përfitimit

Përfituesit e mundshëm: Fermerë, grup fermerësh, SHBB, person fizik ose juridik;

- a. Aplikues është pika e grumbullimit të perimeve;
- b. Grumbulluesi të ketë kontratë me fermerët që kanë serra të kultivuar me domate, spec, kastravec dhe bostanore në tunele për blerjen e prodhimit dhe të autofaturojë fermerët individualë, për prodhimin e blerë;
- c. Grumbulluesit i paguhen jo më shumë se 12 lekë për fidan, nga të cilat i paguan fermerit jo më pak se 50% të vlerës së subvencionuar të fidanit;

ii. Dokumentacioni që dorëzohet nga aplikuesi, pas përfshirjes në listën paraprake të fituesve

- a. Kontratën midis grumbulluesit dhe fermerëve/SHBB-së për blerjen e prodhimit;
- b. Vërtetimin e bankës për numrin e llogarisë bankare;
- c. Dokumenti i pronësisë së tokës nga fermeri;

iii. Dokumentacioni i dorëzuar në momentin e verifikimit

- a. Faturë tatimore e shitjes së fidanëve nga pika e grumbullimit, ku të cilësohet numri i fidanëve të shitur fermerit/SHBB-së dhe vlera për fidan;
- b. Autofaturë e pikës së grumbullimit, lëshuar fermerëve për prodhimet e dorëzuara në pikën e grumbullimit;
- c. Faturat e mësipërme të shoqërohen me dokumentin e pagesës;
- d. Dokumenti i pagesës ndaj fermerit për jo më pak se 50% të vlerës së subvencionuar të fidanëve;

Masa 42: Mbështetje, në vlerën 20 (njëzet) lekë/kg për açuge dhe sardele të peshkuara, ndaj anijeve të peshkimit

i. Kritere specifike të përfitimit

Përfituesit e mundshëm: Person fizik ose juridik në qarqet Lezhë, Durrës, Elbasan dhe Vlorë;

- a. Aplikuesi të ketë në pronësi ose me qira anije të peshkimit për açuge dhe sardele;
- b. Anija e peshkimit të jetë e regjistruar në Regjistrin e Anijeve të Peshkimit;
- c. Të ketë leje të vlefshme peshkimi për pellagjikët e vegjël (me rrethim ose pellagjikë);
- d. Të ketë bërë pagesën e taksës vjetore të lejes;
- e. Të ketë certifikatë zënie dhe Logbook-un përkatës të plotësuar;

ii. Dokumentacioni që dorëzohet nga aplikuesi, pas përfshirjes në listën paraprake të fituesve

- a. Dokumenti i pronësië ose i marrjes me qira të anijes së peshkimit për açuge dhe sardele;
- b. Vërtetimi që anija është regjistruar në Regjistrin e Anijeve të Peshkimit, në emër të subjektit;
- c. Leje peshkimi të vlefshme për vitin e aplikimit;
- d. Dokumenti që vërteton pagesën e taksës vjetore të lejes;
- e. Vërtetimin e bankës për numrin e llogarisë bankare;

iii. Dokumentacioni i dorëzuar në momentin e verifikimit

- a. Faturë shitje me TVSH në stabilimentin e përpunimit të peshkut;
- b. Certifikatë zënie dhe Logbook-un e plotësuar për çdo faturë shitje në stabilimentin e përpunimi të peshkut;
- c. Certifikatë zënie dhe Logbook-un e plotësuar, si dhe faturat e shitjes të produkteve të zëna të përpunuara, në rastin kur anijet janë në pronësi ose të marra me qira nga stabilimentet e përpunimit të peshkut;
- d. Karta teknologjike e produktit të përpunuar të miratuar nga dogana;
- e. Faturat e mësipërme të shoqërohen me dokumentin e pagesës;

Masa 43: Për fermerët/subjektet që kultivojnë jo më pak se 5 ha tokë bujqësore

i. Kritere specifike të përfitimit

Përfituesit e mundshëm: Fermerë, grup fermerësh, SHBB, person fizik ose juridik;

- a. Materiali mbjellës dhe shumëzues bimor të jetë i certifikuar;
- b. Toka të jetë në pronësi të aplikuesit dhe/ose me qira për të paktën për 1 vit;

ii. Dokumentacioni që dorëzohet nga aplikuesi, pas përfshirjes në listën paraprake të fituesve

- a. Dokumenti i dakortësisë së anëtarëve të grup fermerëve, SHBB apo ortakëve të subjektit para noterit, për objektin që aplikon;
- b. Dokumentacionin e pronësisë së tokës apo i marrjes me qira;
- c. Vërtetimin e bankës për numrin e llogarisë bankare.

iii. Dokumentacioni i dorëzuar në momentin e verifikimit

- a. Për farat e prodhuar në vend:
 - Faturë tatimore e blerjes së farave, lëshuar nga subjekti tregtues, ku specifikohet lloji dhe sasia e farave të blera;
 - Një fotokopje të certifikatës zyrtare për materialin mbjellës (lëshuar nga ESHFF), nga subjekti i certifikuar me nënshkrim e vulë të njomë të subjektit tregtues.
- b. Për farat e importuara:
 - Faturën tatimore të blerjes lëshuar nga subjekti tregtues ose aktin e zhdoganimit, ku specifikohet specia, kultivari dhe sasia e materialit mbjellës të blerë;
 - Fotokopje të certifikatës së origjinës/certifikatës fitosanitare/certifikatës nga AKU, të vërtetuar me origjinalen me nënshkrimin e vulë të njomë të subjektit tregtues;

VI. PROCEDURA QË DO TË NDIQET PËR PËRZGJEDHJEN, VERIFIKIMIN DHE PAGESAT PËR MASAT MBËSHTETËSE ME NR. 1-11, 13-19, 25-29, 30-31, 37-38, 41-43

1. Përveç sa përcaktohet në Kreun IV/ Aplikimi on-line, aplikimi për masën mbështetëse 30, bëhet mbi bazën e parashikimit të lindjeve në 100% të numrit të deleve/dhive/lopëve të tufës ekzistuese, të vërtetuar nga sistemi RUDA, ndërsa për masën 31, 37, 41 dhe 42 bëhet mbi bazën e parashikimit për sasi të përkatëse (numrit të enëve për transportin e qumështit, sasinë e qumështit, fidanëve të perimeve, açuqeve e sardeleve), por financimi do të bëhet respektivisht sipas numrit faktik të lindjeve të konstatuara në momentin e verifikimit dhe sasive faktike të vërtetuara me faturat përkatëse.
2. Në momentin e përfundimit të aplikimit shfaqet varianti i printueshëm i aplikimit, me kodin e aplikimit, masën dhe të dhënat e aplikimit, datën dhe orën e aplikimit dhe nr. telefonit të aplikuesit. Formulari i aplikimit firmoset nga përfaqësuesi i AZHBR dhe nga aplikuesi dhe depozitohet në dosjen e aplikuesit. Formulari i firmosur nga të dy palët i jepet edhe aplikuesit. Aplikuesi duhet të ruajë formularin e printuar nga sistemi, për ta pasur si dokument identifikimi për aplikimin e bërë. Kopja e dytë ruhet në zyrën e aplikimit, për tu bërë pjesë e dosjes së aplikuesit.
3. AZHBR gjatë gjithë periudhës së aplikimit bën kontrollin administrativ të aplikimeve, për dokumentacionin që gjenerohet nga sistemi. Nëse ndonjë dokument nuk është e mundur të gjenerohet nga sistemi, lajmërohet aplikuesi ta sigurojë atë nga institucionet përkatëse dhe ta sjellë në zyrën e aplikimit, bashkë me dokumentacionin tjetër, që kërkohet sipas masës përkatëse, nëse aplikuesi do të përfshihet në listën paraprake të fituesve.
4. Me përfundimin e fazes së aplikimit, sistemi gjeneron automatikisht listat e aplikuesëve për çdo masë mbështetëse, sipas parimit “Kush vjen i pari renditet i pari”, përveç aplikuesve për masat nr. 1-11 dhe 43 renditja e të cilëve bëhet sipas vlerësimit me pikë të kriterit “madhësi e sipërfaqes” dhe parimit “Kush vjen i pari renditet i pari”, për aplikuesit me pikë të barabarta.
5. Renditja e aplikimeve bëhet në rang kombëtar dhe për çdo masë mbështetëse.
6. Me përfundimin e aplikimeve dhe kontrollit administrativ të dokumenteve që gjenerohen online, AZHBR shpall në faqen e saj të internetit listën me renditjen e aplikuesve në rang kombëtar, për çdo masë mbështetëse.
7. Aplikuesit e renditur mbi vijën, referuar tavaneve të financimit për çdo masë mbështetëse, përbëjnë **listën paraprake të fituesve**, e cila e printuar afishohet në zyrat e aplikimit. Këtij rregulli nuk i nënshtrohen, aplikuesit për masat nr. 30, 31, 37, 41 dhe 42, të cilët përfshihen të gjithë në listën paraprake të fituesve dhe nëse plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe specifike, shpallen fitues, ndërsa pagesat bëhen sipas parimit “Paguhet i pari kush sjell faturat i pari”, deri në përfundimin e fondit të parashikuar për masën përkatëse.
8. Aplikuesit e përfshirë në listat paraprake të fituesve, sjellin në zyrat përkatëse të aplikimit, brenda 10 ditësh pune nga përfundimi i periudhës së aplikimit, dokumentacionin që kërkohet sipas masës mbështetëse dhe/ose dokumentin që nuk është gjeneruar nga sistemi sipas njoftimit të marrë nga AZHBR-ja.

9. Dokumentacioni origjinal/i noterizuar i dorëzuar nga aplikuesit në zyrat e aplikimit bashkë me formularin e pranimit të dokumentave të firmosur nga të dy palët dhe në fund të procesit të skanimit dorëzohet me protokoll të brendshëm në Sektorin e SPAP/AZHBR;
10. DPAP/SPAP bën kontrollin administrativ të dokumentacionit, si të atyre që gjenerohen nga sistemi online dhe të atyre të dorëzuara dhe/ose të kërkuara nga aplikuesit në variantin hard copy dhe në përputhje me kriteret, aprovon/skualifikon aplikimet përkatëse;
11. Në çdo qark, për verifikimin të aplikimeve, ngrihet “Grupi i Verifikimit të Aplikimeve”, i përbërë nga 2 inspektorë të AZHBR-së. Grupi i Verifikimit të Aplikimeve miratohet nga Drejtori i Përgjithshëm i AZHBR.
12. Grupi i Verifikimit të Aplikimeve bën verifikimin në vend të aplikimit, duke lajmëruar paraprakisht aplikuesin për praninë e tij ose të përfaqësuesit ligjor të pajisur me prokurë.
13. Verifikimi për masën mbështetëse nr. 30, për lindjet e matrikulluara, bëhet në periudhën prill-maj për të imtat dhe tetor-nëntor për gjedhin. Grupi i verifikimit para vajtjes në terren duhet të terheqë në DB regjistrin elektronik të lindjeve të reja përkatëse.
14. Për masën mbështetëse nr. 16 dhe 43, në momentin e verifikimit, toka të jetë e mbjellë dhe të jetë e verifikueshme bimësia për çdo kulture.
15. Në momentin e verifikimit, për masat 13, 14 dhe 19 pajisjet përkatëse të jenë të instaluar dhe funksionale, ndërsa për masat 15 dhe 17, plasmasi termik dhe rrjetat mbrojtëse të jenë të vendosura.
16. Për masat 1-11 dhe 43, kur nga verifikimi në terren rezultojnë diferenca në sipërfaqen e mbjellë deri në 20% krahasuar me sipërfaqen e deklaruar në aplikim, bëhet rivlerësimi i renditjes në listën e fituesve duke financuar sipërfaqjen faktike, ndërsa për diferenca mbi 20%, krahas rivlerësimit, pagesa bëhet për sipërfaqen faktike duke zbritur dyfishin e diferencës së sipërfaqes, për pjesën takuese të mbështetjes referuar faturave përkatëse.
17. Grupi i verifikimit në prani të aplikuesit ose të përfaqësuesit ligjor, kryen verifikimet e nevojshme dhe plotëson formularin e verifikimit sipas masës përkatëse. Formulari i verifikimit firmoset nga aplikuesi/përfaqësuesi i tij ligjor dhe gjithë grupi i verifikimit. Për çdo rast aplikuesi ose ndonjë përfaqësues i grupit të verifikimit mund të bëjë observimet e nevojshme dhe të firmosë për to.
18. Kur grupi i verifikimit ka mendime të ndryshme në lidhje me gjetjet faktike në terren, një ekip i Drejtorisë së Kontrollit të AZHBR-së qendër bën riverifikim të rastit, vendimi i argumentuar i të cilit është i pa kontestueshëm nga palët.
19. Me përfundimin e verifikimit në terren, inspektori i AZHBR hedh në sistem rezultatin e kontrollit dhe variantin e skanuar të Formularit të Verifikimit, faturën/faturat dhe çdo dokument tjetër të marrë në momentin e verifikimit.
20. Grupi i verifikimit çdo 15 ditë pune dërgon në AZHBR/DAP, formularët origjinal të verifikimit të aplikimeve të kontrolluara, si dhe faturat/dhe ose dokumentat e dorëzuara sipas masës mbështetëse të shoqëruara me formularin e dorëzimit të dokumentave në AZHBR.
21. Aplikimet e realizuara konform kërkesave të këtij udhëzimi, kalojnë për financim tek përfituesi.

22. AZHBR shpall në faqen e saj të internetit, *listën e fituesve* me shumat përkatëse të përfitimit, pasi është bërë verifikimi në terren dhe financimit.

Lëvizja e vizës së financimit dhe rialokimi i fondeve

23. Kur nga kontrolli administrativ dhe kontrolli në terren, rezultojnë aplikime të refuzuara nga AZHBR për mosplotësim të kritereve të përfitimit apo moskryerje të investimit, bëhet plotësimi i fondit më fitues të tjerë të masës nga aplikuesit e radhës.
24. Për projektet e skualifikuara nga kontrollet administrative dhe në terren, AZHBR njofton aplikuesit duke bashkëngjitur edhe arsyen e skualifikimit.
25. Në rast të zhvendosjes së vizës, aplikuesit që përfitojnë nga kjo zhvendosje, sjellin brenda 10 ditësh pune, në zyrat e aplikimit dokumentacionin përkatës, sipas masave mbështetëse për të cilën ka aplikuar (vetëm dokumentacioni që nuk gjenerohet nga sistemi).

VII. KRITERET E PËRFITIMIT DHE PROCEDURAT QË ZBATOHEN PËR MASËN MBËSHTETËSE NR. 39

Mbështetje për sistemet e monitorimit të anijes për pajisjet MTU (Njësi Transmetuese të Sinjalit) të instaluar në bordin e anijeve të peshkimit për identifikimin dhe lokalizimin e anijeve nëpërmjet satelitit.

i. Kriteret specifike të përfitimit

Përfituesit e mundshëm: Organizatat e Menaxhimi të Peshkimit, në peshkimin detar Durrës, Vlorë, Shëngjin dhe Sarandë;

- a. Përfituesit të kenë anije peshkimi me gjatësi jo më të vogël se 12 metër;
- b. Të kenë leje peshkimi të vlefshme;
- c. Të kenë paguar taksën vjetore të lejes së peshkimit;
- d. Të ketë paguar vlerën e transmetimit të sinjalit për një periudhë së paku 6 mujore, në numrin e llogarisë së përcaktuar nga Ministria.

ii. Proçedura që do të ndiqet

Së bashku me Formularin e Aplikimit, Organizatat e Menaxhimi të Peshkimit do të sjellë në AZHBR dokumentet e mëposhtme:

- a. Dokumenti që vërteton statusin e aplikantit (OMP);
- b. Listën e pronarëve që disponojnë anije me kriteret e mësipërme dhe numrin e anijeve;
- c. Fotokopje të ID-ve të çdo pronari anije të përfshirë në listën e mësipërme;
- d. Fotokopje të lejeve të peshkimit të pronarëve;
- e. Fotokopje të mandat pagesës për taksën vjetore të lejes së peshkimit;

Dokumentet e mësipërm, duhet të dorëzohen në AZHBR-Qendër, në rrugë protokollare brenda **datës 09.03.2018**.

AZHBR, sipas legjislacionit në fuqi për prokurimet publike, do të shpallë kriteret dhe subjektet fituese që do të realizojnë shërbimin.

Pajisjet MTU duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike sipas Aneksit 13, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Me përfundimin e shërbimit të kontraktuar (Instalimin e Njësive të transmetimit të sinjalit në të gjitha anijet), Operatori Ekonomik paraqet në AZHBR:

- a. Kërkesën për pagesë për shërbimin e kryer;
- b. Faturë tatimore të OE për shërbimin e kryer/ose invoice kur subjekti nuk është kompani shqiptare;
- c. Akt zhdoganimit për pajisjet që vijnë nga jashtë vendit, shoqëruar me specifikimet teknike dhe vlerën përkatëse;
- d. Certifikatën e origjinës dhe garancisë për pajisjet MTU;
- e. Listat e firmosura nga përfituesit për shërbimin e kryer (listat të jenë të firmosura dhe vulosura nga OE dhe OMP);
- f. Akt dorëzimi apo Proces-Verbal për instalimin në bordin e anijeve të pajisjes MTU;
- g. Fotokopje e mandat pagesës për vlerën e transmetimit të sinjalit për një periudhë 6 mujore;
- h. Vërtetimin e bankës për numrin e llogarisë bankare

Shërbimi do të quhet i kryer kur pajisjet MTU të jenë të instaluar në bordin e anijeve dhe të jenë funksionale, të vërtetuara në sistemin VMS të instaluar në MBZHR dhe QNOD.

Efektet financiare të kontratës do të fillojnë pasi MBZHR të ketë dhënë konfirmimin që sistemi VMS të jetë i përditësuar dhe përputhet me pajisjet e përzgjedhura.

iii. Verifikimi dhe Pagesa

Për monitorimin dhe verifikimin e shërbimit të kryer ngrihet “Grupi i Monitorimit dhe Verifikimit”.

Grupi i monitorim-verifikimit përbëhet nga 3 anëtarë, nga të cilët 2 inspektorë të AZHBR-së dhe inspektori i peshkimit në portin përkatës.

Grupi i monitorim-verifikimit miratohet nga Drejtori i AZHBR.

Grupi i monitorim-verifikimit, monitoron procedurën e shërbimit, verifikon shërbimin e kryer, mban proces verbalet përkatëse dhe plotëson formularin e verifikimit.

AZHBR-ja, pas kontrollit administrativ të dokumentacionit dhe llogaritjeve përkatëse bën financimin e shumës së lekëve në numrin e llogarisë së operatorit ekonomik.

VIII. KRITERET SPECIFIKE DHE DOKUMENTACIONI PËR MASAT MBËSHTETËSE NR. 12; 20-24; 32-36; 40 dhe 44-52

Gjatë periudhës së aplikimit, aplikuesi sjell në AZHBR të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas masave përkatëse. Dokumentacioni i mbyllur në zarf, dorëzohet me protokoll në adresën Rruga “Muhamet Gjollesha, nr. 56 Tiranë.

1. Shpenzime të papranueshme:

- Blerje e gjësë së gjallë, truallit apo ndërtesës;
- Shpenzimet e përgjithshme si hartimi i biznesplanit, tarifat e inxhinierëve, arkitektëve, studime fizibiliteti, patenta, licenca, etj.;
- Shpenzime operative si transporti i makinerive dhe linjave të ndryshme, elektriciteti, uji, gazi, mirëmbajtje, amortizim dhe kostot e qirasë, etj.
- Detyrimet doganore dhe të importit ose çdo tarifë që ka efekt të njëjtë;
- Blerje, qira ose lizing për tokën apo ndërtesat ekzistuese;
- Gjoba apo detyrime gjyqësore;
- Kostot operative të aktivitetit;
- Makineri dhe pajisje të përdorura;
- Detyrime bankare si kosto garancish e të tjera të ngjashme;
- Kontributet në natyrë;
- Kosto të shkëmbimit valutor;
- Shpenzime të kryera në objekt para lidhjes së kontratës me AZHBR-në;
- Kosto promovimi për të bërë publik produktin;
- Aplikuesi i cili ka dhe menaxhon mbi 25% kapital publik në sipërmarrjen e vet.

2. Kriteret specifike të përfitimit, kriteret konkurruese dhe dokumentacioni

Masa 12: Ndërtimi i serrave diellore për kultivimin e domates, kastravecit, dhe specit me sipërfaqe jo më pak se 0.2 ha dhe jo më shumë s 1 ha.

i. Kriteret specifike të përfitimit

Përfituesit e mundshëm: Fermerë individualë, SHBB, persona fizik/juridik;

- a. Personat fizikë/juridikë të jenë të regjistruar për ushtrimin e veprimtarisë së pranueshme për të cilën aplikojnë;
- b. Toka të jetë në pronësi të aplikuesit dhe/ose me qira për të paktën 5 vjet, duke filluar nga viti e aplikimit;
- c. Të ketë plan biznesin e detajuar për 5 vjet, sipas modelit standard, të përcaktuar në Aneksin 14, bashkëngjitur këtij udhëzimi:
 - NPV, duhet të dalë ≥ 0 .
 - IRR duhet të dalë \geq Norma e Skontimit.
 - Norma e skontimit që do të përdoret për përlllogaritjen e NPV, është norma e obligacioneve të thesarit 2 vjeçare të pranuar nga Banka e Shqipërisë në ankadin e fundit para hapjes së aplikimeve.

- Në rast të supozimeve të paqarta/pasakta, AZHBR gëzon të drejtën të kërkojë me shkrim informacion shtesë. Nëse nuk arsyetohen dhe mbështeten supozimet me të dhëna faktike të qarta, atëherë ky aplikim skualifikohet.
- Në rast se nuk plotësohen këto kritere, ose nuk është plotësuar plan biznesi standart, aplikimi skualifikohet.

- d. Aplikuesi të ketë planin e vendosjes për ndërtimin e serrave, sipas formularit në Aneksin 15;
- e. Të zbatojë specifikimet teknike sipas tipit të serrave të përcaktuara në Aneksin 16;
- f. Leje ndërtimi nëse serra është me themele të vazhduara dhe deklarata paraprake për kryerje punimesh për serrat e tipeve të tjera;
- g. Aplikuesi duhet të ketë përmbushur detyrimet tatimore, lëshuar nga zyra e tatim- taksave për personat fizikë dhe juridikë;
- h. Aplikuesi nuk duhet të jetë në ndjekje penale për mashtrim, korrupsion apo për çdo lloj veprimtarie tjetër të paligjshme;
- i. Aplikuesit nuk duhet të jenë debitor ndaj AZHBR dhe/ose MBZHR;
- j. Aplikuesi nuk duhet të jetë debitor me status më të ulët se 4 ndaj institucioneve financiare;
- k. Investimi nuk duhet të fillojë para lidhjes së kontratës.

ii. Kriteret konkurruese

a. Sipërfaqja e serës	75 pikë
b. Tipi i serës	20 pikë
c. Numri i vendeve të reja të punës pas investimit	5 pikë
TOTALI	100 pikë

Vlerësimi i aplikimeve:

Për sipërfaqen (Max 75 pikë):

Vlerësimin maksimal për sipërfaqen e fiton aplikimi me sipërfaqen maksimale të lejueshme (1 ha), të tjerët vlerësohen në përpjesëtim të drejtë me këtë sipërfaqe.

Aplikimet me sipërfaqe më të vogla se 1 ha llogariten në mënyrë proporcionale sipas formulës:

$X = \text{Sipërfaqja për të cilën aplikon (në dynym)} * 75 / \text{sipërfaqen maksimale (10 dynym)}$.

Tipi i serës (Max 20 pikë):

- Sera me lartësi 4 m 20 pikë
- Sera me lartësi 2.8 m 10 pikë

Numri i vendeve të reja të punës pas investimit (Max 5 pikë):

Aplikuesi me numrin më të lartë të vendeve të reja të punës merr 5 pikë. Aplikuesit e tjerë marrin sipas formulës:

$X = \text{Nr i vendeve të reja të punës} * 5 / \text{Nr e vendeve maksimale të reja të punës për masën}$.

iii. Dokumentacioni i dorëzuar në AZHBR

Bashkëngjitur me kërkesën për aplikim aplikuesi duhet të dorëzojë dhe dokumentacionin e mëposhtëm:

- a. Formulari i aplikimit;

- b. Fotokopje e firmosur e kartës së identitetit/pasaportës biometrike së aplikuesit apo përfaqësuesit ligjor;
- c. Plan biznesi i printuar dhe në CD i detajuar për 5 vjet, sipas modelit standart, të përcaktuar në Aneksin 14, bashkëngjitur këtij udhëzimi;
- d. Dokumentin që vërteton statusin e aplikuesit (fermer, SHBB, person fizik/juridik), nëse nuk gjenerohet nga sistemi;
- e. Dokumenti i dakortësisë së anëtarëve të SHBB apo ortakëve të subjektit para noterit, për objektin që aplikon;
- f. Vërtetim nga Gjykata/Prokuroria (si i/e padënuar për mashtrim, korrupsion apo për çdo lloj veprimtarie tjetër të paligjshme);
- g. Raporti i kredimarrësit nga Banka e Shqipërisë për aplikuesin;
- h. 3 oferta origjinale shoqëruar, me datë, firmë dhe vulë për çdo lloj investimi, të shoqëruar me formularin e regjistrimit në QKB të subjekteve ofertuese, me specifikimet teknike të krahasueshme dhe vlefshmërinë e ofertës. Ofertuesit nuk duhet të jenë në konflikt interesi me aplikuesin dhe me njëri-tjetrin. Oferta për të gjithë elementët e serrës duhet të jetë nga një subjekt i vetëm;
- i. Planvendosjen e serrës (skicën e projektit);
- j. Vërtetimin e lëshuar nga Zyra e Tatim Taksave që vërteton se aplikuesi ka përmbushur detyrimet koherente të kontributeve shoqërore, shëndetsore, etj. Ky dokument duhet të jetë lëshuar jo më parë se 30 ditë nga data e dorëzimit të kërkesës për pagesë;
- k. Dokumenti i pronësisë së tokës ose qirasë, për të paktën 5 vjet duke filluar nga viti e aplikimit;
- l. Vërtetimin e bankës për numrin e llogarisë bankare.

I gjithë dokumentacioni i kërkuar më sipër kur dorëzohet si fotokopje (me përjashtim të kartës së identitetit ose pasaportës biometrike, formularit të regjistrimit në QKB të ofertuesve) të jetë i noterizuar dhe i lëshuar jo më parë se 3 muaj nga data e aplikimit.

I gjithë dokumentacioni i kërkuar të jetë në gjuhën shqipe ose në rast se është në gjuhë të huaj të jetë i përkthyer nga një përkthyes i autorizuar.

iv. Dokumentacioni dhe kërkesa për financim

Sipas llojit të investimit, aplikuesi paraqet pranë AZHBR-së kërkesën për financim. Financimi do të realizohet sipas kushteve të përcaktuara në kontratë.

Së bashku me kërkesën për financim, aplikuesi paraqet edhe dokumentacionin e mëposhtëm:

- a. Situacionin e punimeve të kryera shoqëruar me faturën tatimore;
- b. Faturën/faturat tatimore të blerjes, shoqëruar me specifikimet teknike të elementeve përkatës të sistemit dhe vlerën e elementëve përbërës;
- c. Kopje të transfertës bankare për shumën përkatëse;
- d. Akt zhdoganimit për pajisjet që vijnë nga jashtë vendit, shoqëruar me specifikimet teknike dhe vlerën e elementëve përbërës;
- e. Vërtetimin e lëshuar nga Zyra e Tatim Taksave që vërteton se aplikuesi ka përmbushur detyrimet koherente të kontributeve shoqërore, shëndetësore, etj. Ky dokument duhet të jetë lëshuar jo më parë se 30 ditë nga data e dorëzimit të kërkesës për pagesë;

Masat 20-24: Rritja dhe përmirësimi i kapaciteteve të grumbullimit, ruajtjes, pastrimit, seleksionimit, paketimit dhe përpunimit të prodhimit bujqësor dhe peshkimit.

Masat 32-36: Për përmirësimin e zinxhirit të sigurisë ushqimore të produkteve blegtorale.

i. Kriteret specifike të përfitimit

Përfituesit e mundshëm: Fermer, SHBB, person fizik ose juridik.

- a. Të jenë të regjistruar për ushtrimin e veprimtarisë për të cilën dorëzohet aplikimi në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi në Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- b. Për investimet e përfshira në këto masa, aplikuesi duhet të jetë i pajisur me licencat e kërkuara nga legjislacioni në fuqi;
- c. Të ketë plan biznesin e detajuar për 5 vjet, sipas modelit standard, të përcaktuar në Aneksin 14, bashkëngjitur këtij udhëzimi;
 - NPV, duhet të dalë ≥ 0 .
 - IRR duhet të dalë \geq Norma e Skontimit.
 - Norma e skontimit që do të përdoret për përlogaritjen e NPV, është norma e obligacioneve të thesarit 2 vjeçare të pranuar nga Banka e Shqipërisë në ankadin e fundit para hapjes së aplikimeve.
 - Në rast të supozimeve të paqarta/pasakta, AZHBR gëzon të drejtën të kërkojë me shkrim informacion shtesë. Nëse nuk arsyetohen dhe mbështeten supozimet me të dhëna faktike të qarta, atëherë ky aplikim skualifikohet.
 - Në rast se nuk plotësohen këto kritere, ose nuk është plotësuar plan biznesi standart, aplikimi skualifikohet.
- d. Për investime përfshirë në këto masa, aplikuesi duhet të ketë lejen e ndërtimit të miratuar ose kërkesën për leje ndërtimi. Lidhja e kontratës do të bëhet vetëm për subjektet me leje ndërtimi;
- e. Trualli/ambienti që do të përdoret për investimet, të jetë në pronësi, ose i marrë me qira (për jo më pak se 10 vjet nga momenti i aplikimit), në emër të subjektit aplikues.
- f. Për ndërtimin e thertoreve të reja aplikuesit të jenë nga qarqet Dibër dhe Kukës, por jo më shumë se një përfitues për qark;
- g. Në rastet e projekteve me karakter blegtoral (masa 34), subjekti duhet të ketë jo më pak se 100 krerë të imta të matrikulluara/10 krerë lopë të matrikulluara / 10 dosa ose kapacitet me jo më pak se 10 000 shpendë;
- h. Parametrat/normat për krerë për ndërtimin e ambjenteve për mbarështimin e kafshëve të jenë sipas Aneksit 17;
- i. Investimi për të cilin aplikuesi është kualifikuar, nuk duhet të fillojë para lidhjes së kontratës.
- j. Mallrat, linjat/pajisjet dhe makineritë duhet të jenë të reja;
- k. Aplikuesi duhet të ketë përmbushur detyrimet tatimore, lëshuar nga zyra e tatim taksave për personat fizikë dhe juridikë;
- l. Aplikuesi nuk duhet të jetë në ndjekje penale për mashtrim, korrupsion apo për çdo lloj veprimtarie tjetër të paligjshme;
- m. Aplikuesët nuk duhet të jenë debitor ndaj AZHBR dhe/ose MBZHR;
- n. Aplikuesi nuk duhet të jetë debitor me status më të ulët se 4 ndaj institucioneve financiare;
- o. Investimi nuk duhet të fillojë para lidhjes së kontratës.

ii. Kriteret konkurruese

- | | |
|----------------------------------|---------|
| a. Vlera investimit të pranuar | 60 pikë |
| b. Lloji i investimit | 30 pikë |
| c. Nr i vendeve të reja të punës | 5 pikë |

d. Nr. i të punësuarve aktual
TOTALI

5 pikë
100 pikë

Vlerësimi i aplikimeve:

Vlera e Investimit (Max 60 pikë)

- Sipas skemes vlere maksimale e investimit 60 pikë;
- Aplikimet me vlere më të vogla në mënyrë proporcionale sipas formulës
 $X = \text{Vlerën e aplikimit} * 60 / \text{Vlera max e inv.}$

Lloji i investimit (Max 30 pikë):

- Investime komplekse (Ndërtim/rikonstruksion + linja/paisje/makineri) etj, (me kusht që ndërtimi mos ketë më pak se 50% të vlerës dhe linja/paisje/makineri jo më pak se 20% të vlerës së investimit). 30 pikë
- Ndërtim dhe/ose rikonstruksione 15 pikë
- Linja/makineri/paisje për thertore, linja përpunimi fruta-perime, vaj ulliri dhe verë, linja seleksionimi, paketimi, pastrimi, përfshirë dhe ambalazhe, linja për filetimin, tharjen, tymosjen e produkteve peshkore nga liqenet; Makineri dhe pajisje për mekanizimin dhe modernizimin e proceseve të punës në fermat blegtorale, sisteme ftohëse të qumështit për pikat e grumbullimit dhe/ose përpunimit. 10 pikë

Numri i vendeve të reja të punës pas investimit (Max 5 pikë):

- Aplikuesi me numrin më të lartë të vendeve të reja të punës merr 5 pikë. Aplikuesit e tjerë marrin sipas formulës:
- $X = \text{Nr i vendeve të reja të punës} * 5 / \text{Nr e vendeve maksimale të reja të punës për masën.}$

Numri i të punësuarve (Max 5 pikë):

- Për çdo të punësuar 1 pikë, por jo më shumë se 5 pikë në total 5 pikë

Pikët për numrin e punonjësve, përfitohen kundrejt një dokumenti zyrtar të firmosur dhe të vulosur nga organet kompetente.

iii. Dokumentacioni i dorëzuar në AZHBR

- a. Formulari i aplikimit (në rastet kur aplikuesi është fermer duhet të plotësojë regjistrin e fermës);
- b. Kopja e firmosur e kartës së identitetit ose pasaportës biometrike të aplikuesit apo përfaqësuesit ligjor;
- c. Dokumenti i dakortësisë së anëtarëve të SHBB apo ortakëve të subjektit para noterit, për objektin që aplikon;
- d. Regjistri elektronik i kafshëve të fermës konfirmuar nga DB përkatëse, nëse nuk gjenerohet nga sistemi/regjistrat zyrtarë (masa 34);
- e. Plan biznesi i printuar dhe në CD i detajuar për 5 vjet, sipas modelit standard, të përcaktuar në Aneksin 14, bashkëngjitur këtij udhëzimi;
- f. Projekti dhe preventivi origjinal, i firmosur dhe vulosur/firmë digjitale nga një inxhinier i licencuar për ndërtim dhe rikonstruksion. Projekti duhet të përmbajë pjesën arkitekturore dhe konstruktive;
- g. Për të gjitha investimet për ngritje dhe/ose rikonstruksion ambjentesh të përmendura në këtë masë, dokumenti origjinal ose fotokopje e noterizuar e lejes së ndërtimit/rikonstruksioni ose kërkesën

për leje ndërtimi në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi; Kontrata do të lidhet vetëm pas dorëzimit të lejes së ndërtimit;

- h. 3 oferta origjinale shoqëruar, me datë, firmë dhe vulë për çdo lloj investimi, të shoqëruar me formularin e regjistrimit në QKB të subjekteve ofertuese, me specifikimet teknike të krahasueshme dhe vlefshmërinë e ofertës. Ofertuesit nuk duhet të jenë në konflikt interesi me aplikuesin dhe me njëri tjetrin;
- i. Vërtetimin lëshuar nga zyra e tatim taksave për personat fizikë dhe juridikë. Ky dokument duhet të jetë lëshuar jo më parë se 30 ditë nga data e aplikimit;
- j. Raporti i kredimarrësit nga Banka e Shqipërisë;
- k. Vërtetim nga Gjykata/Prokuroria që nuk është në ndjekje penale për mashtrim, korrupsion apo për çdo lloj veprimtarie tjetër të paligjshme;
- l. Leje apo licenca sipas legjislacionit në fuqi për aktivitetin që mbështeten;
- m. Për çdo investim përfshirë në këto masa, aplikuesi është i detyruar të dorëzojë të gjitha lejet apo licencat e kërkuara nga legjislacioni në fuqi;
- n. Dokumentacioni i pronësisë ose i marrjes me qira së tokës, truallit apo godinës ku do të investohet (qiraja për jo më pak se 10 vjet nga momenti i aplikimit), në emër të subjektit aplikues;
- o. Vërtetimin e bankës për numrin e llogarisë bankare.

I gjithë dokumentacioni i kërkuar më sipër kur dorëzohet si fotokopje (me përjashtim të kartës së identitetit, pasaportës biometrike dhe formulari të regjistrimit në QKB të subjekteve ofertuese) të jetë i noterizuar dhe i lëshuar jo më parë se 3 muaj nga data e aplikimit.

I gjithë dokumentacioni i kërkuar të jetë në gjuhën shqipe ose në rast se është në gjuhë të huaj të jetë i përkthyer nga një përkthyes i autorizuar.

iv. Dokumentacioni dhe kërkesa për pagesë

Së bashku me kërkesën për financim, aplikuesi paraqet edhe dokumentacionin e mëposhtëm:

- a. Kontratën me sipërmarrësin e punimeve;
- b. Situacionin e punimeve të kryera me faturën tatimore shoqëruar me librezën e masave (për ndërtim ose rikonstruksion);
- c. Faturën/faturat tatimore të blerjes së linjave/mjeteve/pajisjeve, shoqëruar me specifikimet teknike, dhe vlerën e elementëve përbërës;
- d. Akt zhdoganimit për pajisjet që vijnë nga jashtë vendit, shoqëruar me specifikimet teknike dhe vlerën ekonomike të elementëve përbërës;
- e. Vërtetimin e lëshuar nga zyra e tatim taksave për personat fizikë dhe juridikë. Ky dokument duhet të jetë lëshuar jo më parë se 30 ditë nga data e aplikimit;
- f. Transaksionin bankar dhe/ose fotokopje e SËIFT për të gjitha pagesat ndërkombëtare që vërteton transferimin e fondeve nga aplikuesi tek shitësi;
- g. Vërtetim nga AKU dhe inspektoriati shtetëror i mjedisit, që konfirmon se stabilimenti ushqimor përmbush standardet përkatëse për sigurinë ushqimore dhe mbrojtjen e mjedisit.

Masa 40: Mbështetje deri në 70% të vlerës, por jo më shumë se 20 000 000 (njëzet milion) lekë për instalimin e bankinave lundruese, nga Organizatat e Menaxhimit të Peshkimit.

i. Kriteret specifike të përfitimit

Përfituesit e mundshëm: Organizatë Menaxhimi Peshkimi (OMP) në portet e peshkimit Durrës, Sarandë, Vlorë e Shëngjin.

- a. Porti ku do të instalohet bankina lundruese të jetë në përdorim të OMP-së;
- b. Të ketë marre miratimin e Komisioni Konsultativ Qendror i Peshkimit dhe Akuakulturës (KKQPA) në MBZHR për instalimin dhe vendosjen e bankinës;
- c. Të ketë plan biznesin e detajuar për 5 vjet, sipas modelit standard, të përcaktuar në Aneksin 14, bashkëngjitur këtij udhëzimi;
 - NPV, duhet të dalë ≥ 0 .
 - IRR duhet të dalë \geq Norma e Skontimit.
 - Norma e skontimit që do të përdoret për përlllogaritjen e NPV, është norma e obligacioneve të thesarit 2 vjeçare të pranuar nga Banka e Shqipërisë në ankadin e fundit para hapjes së aplikimeve.
 - Në rast të supozimeve të paqarta/pasakta, AZHBR gëzon të drejtën të kërkojë me shkrim informacion shtesë. Nëse nuk arsyetohen dhe mbështeten supozimet me të dhëna faktike të qarta, atëherë ky aplikim skualifikohet.
 - Në rast se nuk plotësohen këto kritere, ose nuk është plotësuar plan biznesi standart, aplikimi skualifikohet.
- d. Struktura të ketë një gjatësi jo më të madhe se 120 m dhe të jetë e çmontueshme;
- e. Elementet notues të bankinave të kenë gjatësi 6 – 12 m dhe gjerësi 2 – 3 m;
- f. Struktura e elementeve të jete prej çeliku e galvanizuar sipas normatives UNI EN ISO 1461;
- g. Bërthama e elementeve notues të jetë prej plastike të ngopur (polistirol, polistiren etj) me një dendësi së paku 10kg/m³;
- h. Elementet notues të jenë të pajisur me kalunja çdo 3 m për lidhjen e barkave.
- i. Aplikuesi duhet të ketë përmbushur detyrimet tatimore, lëshuar nga zyra e tatim taksave për personat fizikë dhe juridikë;
- j. Aplikuesët nuk duhet të jenë debitor ndaj AZHBR dhe/ose MBZHR;
- k. Investimi nuk duhet të fillojë para lidhjes së kontratës.

ii. Kriteret konkurruese

a. Vlera e investimit të pranuar	70 pikë
b. Numri i barkave që ankorohen	30 pikë
TOTALI	100 pikë

Vlerësimi i aplikimeve:

Vlera e Investimit (Max 70pikë)

- Sipas masës vlera maksimale e investimit 70 pikë;
- Aplikimet me vlera më të vogla në mënyrë proporcionale sipas formulës:
 $X = \text{Vlerën e aplikimit} * 70 / \text{Vlera max e investimit}$.
- Sipas masës numri maksimal i barkave 30 pikë;
- Aplikimet me vlera më të vogla në mënyrë proporcionale sipas formulës:
 $X = \text{Numri i barkave në aplikim} * 30 / \text{Vlera maksimale e numrit të barkave}$.

iii. Dokumentacioni i dorëzuar në AZHBR

- a. Formulari i aplikimit;
- b. Vendimi i gjykatës për regjistrimin e OMP;
- c. Fotokopje e NIPT-it;
- d. Biznes plani i printuar dhe në CD i detajuar për 5 vjet, sipas modelit standart, të përcaktuar në Aneksin 14, bashkëngjitur këtij udhëzimi;
- e. Planvendosja dhe preventivi origjinal;
- f. Dokumenti origjinal ose fotokopje e noterizuar e miratimit të instalimit të bankines nga KKQPA;
- g. 3 oferta origjinale, me specifikimet teknike të krahasueshme dhe vlerën ekonomike si dhe vlefshmërinë e ofertës. Ofertuesit nuk duhet të jenë në konflikt interesi me aplikuesin dhe me njëri tjetrin; Për ofertat në valutë të huaj do të zbatohet kursi i këmbimit të Bankës së Shqipërisë në ditën e çeljes së thirrjes për aplikim;
- h. Vërtetimin e bankës për numrin e llogarisë bankare;
- i. Vërtetim i lëshuar nga zyra e tatim-taksave që OMP nuk ka detyrime. Ky dokument duhet të jetë lëshuar jo më parë se 30 ditë nga data e aplikimit;

iv. Dokumentacioni dhe kërkesa për pagesë

Aplikuesi paraqet pranë AZHBR-së kërkesën për financim. Financimi do të realizohet sipas kushteve të përcaktuara në kontratë.

Së bashku me kërkesën për financim, aplikuesi paraqet edhe dokumentacionin e mëposhtëm:

- a. Situacionin e punimeve të kryera shoqëruar me faturën tatimore;
- b. Faturën/faturat tatimore të pajisjeve, shoqëruar me specifikimet teknike, dhe vlerën e elementëve përbërës;
- c. Akt zhdoganimit për pajisjet që vijnë nga jashtë vendit, shoqëruar me specifikimet teknike dhe vlerën e elementëve përbërës;
- d. Transaksionin bankar dhe/ose fotokopje e SËIFT për të gjitha pagesat ndërkombëtare që vërteton transferimin e fondeve nga aplikuesi tek shitësi

Masa 45: Mbështetje për investime në agroturizëm kundrejt planit të biznesit, në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 20 000 000 (njëzet milion) lekë.

Masa 51: Mbështetje për ngritjen e inkubatorëve të prodhimit të produkteve tradicionale të zonës, në 70% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milion) lekë, kundrejt planit të biznesit.

i. Kriteret specifike të përfitimit

Përfituesit e mundshëm: OJF, SHBB, person fizik ose juridik

- a. Aplikuesi për masën 45, duhet të ketë bërë kërkesën pranë Ministrisë së Turizmit për t'u rregjistruar si "Subjekt i certifikuar agroturizmi", referuar VKM, nr 22, datë 21.1.2018, "Për miratimin e kriterëve për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit";
- b. Investimet për masën 45, përfshijnë çdo lloj investimi në shërbim të agroturizmit si veprimtari pritëse, që zhvillohet në një fermë ose njësi tjetër agrokulturore me qëllim për të tërhequr vizitorë, duke u mundësuar atyre pjesëmarrjen në veprimtaritë bujqësore apo veprimtari të tjera ndihmëse,

që zhvillohen në atë mjedis bujqësor. Të pranueshme për mbështetje janë investimet që lidhen me akomodimin, ofrimin e ushqimit e pijeve dhe veprimtari argëtuese/shlodhëse, të lidhura me fermën ose mjedisin përreth;

- c. Investimi në përfundim duhet të përmbushë standardet në fushën përkatëse në përputhje me akomodimin, sigurinë ushqimore dhe mbrojtjen mjedisore;
- d. Të ketë plan biznesin e detajuar për 5 vjet, sipas modelit standard, të përcaktuar në Aneksin 14, bashkëngjitur këtij udhëzimi;
 - NPV, duhet të dalë ≥ 0 .
 - IRR duhet të dalë \geq Norma e Skontimit.
 - Norma e skontimit që do të përdoret për përlllogaritjen e NPV, është norma e obligacioneve të thesarit 2 vjeçare të pranuar nga Banka e Shqipërisë në ankadin e fundit para hapjes së aplikimeve.
 - Në rast të supozimeve të paqarta/pasakta, AZHBR gëzon të drejtën të kërkojë me shkrim informacion shtesë. Nëse nuk arsyetohen dhe mbështeten supozimet me të dhëna faktike të qarta, atëherë ky aplikim skualifikohet.
 - Në rast se nuk plotësohen këto kritere, ose nuk është plotësuar plan biznesi standart, aplikimi skualifikohet.
- e. Aplikuesi duhet të ketë përmbushur detyrimet tatimore, lëshuar nga zyra e tatim taksave për personat fizikë dhe juridikë;
- f. Aplikuesi nuk duhet të jetë në ndjekje penale për mashtrim, korrupsion apo për çdo lloj veprimtarie tjetër të paligjshme;
- g. Aplikuesit nuk duhet të jenë debitor ndaj AZHBR dhe/ose MBZHR;
- h. Aplikuesi nuk duhet të jetë debitor me status më të ulët se 4 ndaj institucioneve financiare;
- i. Investimi nuk duhet të fillojë para lidhjes së kontratës.
- j. Investime të papranueshme për masën 45: Investime per kazino, lojra fati, loto sporti.

ii. Kriteret Konkurruese

a. Vlera investimit të pranuar	55 pikë
b. Numri i vendeve të reja të punës pas investimit	5 pikë
c. Shumëllojshmëri shërbimesh	30 pikë
d. Aplikuese femër	5 pikë
e. Aplikuesi me status emigrant	5 pikë

TOTALI **100 pikë**

Vlerësimi i aplikimeve:

Vlera e Investimit (Max 55 pikë)

- Sipas masës mbështetëse lera maksimale e investimit 55 pikë;
- Aplikimet me vlera më të vogla në mënyrë proporcionale sipas formulës:
$$X = \text{Vlerën e aplikimit} * 55 / \text{Vlera max e investimit}.$$

Numri i vendeve të reja të punës pas investimit (Max 5 pikë):

- Aplikuesi me numrin më të lartë të vendeve të reja të punës merr 5 pikë. Aplikuesit e tjerë marrin sipas formulës:

$$X = \text{Nr i vendeve të reja të punës} * 5 / \text{Nr e vendeve maksimale të reja të punës për masën}.$$

Shumëllojshmëri shërbimesh (Max. 30 pikë):

- Përfitojnë 30 pikë aplikimet të cilat përfshijnë 6 ose me shumë lloje shërbimesh.
- Aplikimet nën 5 lloje shërbimesh, përfitojnë 6 pikë për çdo shërbim të ofruar.

Aplikues femër 5 pikë):

Aplikuesë me status emigrant (5 pikë):

iii. Dokumentacioni i dorëzuar në AZHBR

- Formularin e aplikimit;
- Fotokopje e firmosur e kartës së identitetit/pasaportës biometrike së aplikuesit apo përfaqësuesit ligjor;
- Për masën 45, kërkesa për regjistrim “Subjekt i certifikuar agroturizmi”;
- Dokumentin e NUIS ose NIPT sipas legjislacionit në fuqi për subjektet fizikë dhe juridikë;
- Plan biznesin e printuar dhe në CD i detajuar për 5 vjet, sipas modelit standard, të përcaktuar në Aneksin 14, bashkëngjitur këtij udhëzimi;
- Projektin dhe preventivin origjinal, të firmosur dhe vulosur/firmë digitale nga një inxhinier i licencuar për ndërtim dhe rikonstruksion. Projekti duhet të përmbajë pjesën arkitekturore dhe konstruktive;
- Për aplikuesin me statusin emigrant, kopje të firmosur të certifikatës së rezidencës permanente ose pasaportës nga një shtet tjetër, në momentin e aplikimit.
- Për të gjitha investimet e ngritje dhe /ose rikonstruksion ambjentesh të përmendura në këtë masë, dokumenti origjinal ose fotokopje e noterizuar e lejes së ndërtimit/rikonstruksioni, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;
- 3 oferta origjinale shoqëruar, me datë, firmë dhe vulë për çdo lloj investimi, të shoqëruar me formularin e regjistrimit në QKB të subjekteve ofertuese, me specifikimet teknike të krahasueshme dhe vlefshmërinë e ofertës. Ofertuesit nuk duhet të jenë në konflikt interesi me aplikuesin dhe me njëri tjetrin.
- Vërtetimin lëshuar nga zyra e tatim taksave për personat fizikë dhe juridikë. Ky dokument duhet të jetë lëshuar jo më parë se 30 ditë nga data e aplikimit;
- Aplikuesi nuk duhet të jetë debitor me status më të ulët se 4 ndaj institucioneve financiare;
- Aplikuesi nuk duhet të jetë në ndjekje penale për mashtrim, korrupsion apo për çdo lloj veprimtarie tjetër të paligjshme;
- Leje apo licenca sipas legjislacionit në fuqi për aktivitetin që mbështeten;
- Dokumentacionin e pronësisë së tokës, truallit apo godinës ku do investohet.
- Vërtetimin e bankës për numrin e llogarisë bankare.

I gjithë dokumentacioni i kërkuar më sipër kur dorëzohet si fotokopje (me përjashtim të kartës së identitetit ose pasaportës biometrike, QKB-të e ofertuesve) të jetë i noterizuar dhe i lëshuar jo më parë se 3 muaj nga data e aplikimit.

iv. Dokumenta për kërkesa për financim

Aplikuesi paraqet pranë AZHBR-së kërkesën për financim. Financimi do të realizohet sipas kushteve të përcaktuara në kontratë.

Së bashku me kërkesën për financim aplikuesi paraqet edhe dokumentacionin e mëposhtëm:

- Për masën 45, certifikatën e regjistrimit “Subjekt i certifikuar agroturizmi”;

- b. Situacionin e punimeve të kryera me faturën tatimore shoqëruar me librezën e masave (për ndërtim ose rikonstruksion);
- c. Faturën/faturat tatimore për blerjen e pajisjeve, shoqëruar me specifikimet teknike, dhe vlerën e elementëve përbërës, etj.;
- d. Akt zhdoganimit për pajisjet që vijnë nga jashtë vendit, shoqëruar me specifikimet teknike dhe vlerën ekonomike të elementëve përbërës;
- e. Transaksionin bankar dhe/ose fotokopje e SWIFT për të gjitha pagesat ndërkombëtare që vërteton transferimin e fondeve nga aplikuesi tek shitësi

Masa 44: Mbështetje për ngritjen ose rikonstruksionin e ambienteve për veprimtari të turizmit rural nga 6 deri në 10 dhoma, në 50% të vlerës totale të faturave tatimore por jo më shumë se 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë;

Masa 46: Mbështetje për ngritjen ose rikonstruksionin e ambienteve të prodhimit të produkteve tradicionale të zonës, në 50% të vlerës totale të faturave tatimore por jo më shumë se 1 000 000 (një milion) lekë.

Masa 52: Mbështetje në rrjetin e subjekteve të shitjes me pakicë të produkteve ushqimore të prodhuara në vend, kundrejt planit të biznesit, në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 2 000 000 (dy milion) lekë.

i. Kriteret specifike të përfitimit

Përfituesit e mundshëm: Fermer, SHBB, person fizik ose juridik, ndërsa OJF, për masat 44 dhe 46.

- a. Për masën 44 dhe 46, investimet duhet të realizohen në territorin administrativ të një prej 100 fshatrave, të listuara në Aneksit 18, ndërsa produktet tradicionale të zonave, të jenë sipas përcaktimeve në Aneksin 19;
- b. Për masën 52, të ketë plan biznesin e detajuar për 5 vjet, sipas modelit standart, të përcaktuar në Aneksin 14, bashkëngjitur këtij udhëzimi:
 - NPV, duhet të dalë ≥ 0 .
 - IRR duhet të dalë \geq Norma e Skontimit.
 - Norma e skontimit që do të përdoret për përlogaritjen e NPV, është norma e obligacioneve të thesarit 2 vjeçare të pranuar nga Banka e Shqipërisë në ankadin e fundit para hapjes së aplikimeve.
 - Në rast të supozimeve të paqarta/pasakta, AZHBR gëzon të drejtën të kërkojë me shkrim informacion shtesë. Nëse nuk arsyetohen dhe mbështeten supozimet me të dhëna faktike të qarta, atëherë ky aplikim skualifikohet.
 - Në rast se nuk plotësohen këto kritere, ose nuk është plotësuar plan biznesi standart, aplikimi skualifikohet.
- c. Investimi, në përfundim të tij duhet të përmbushë standardet në fushën përkatëse lidhur me akomodimin, sigurinë ushqimore dhe mbrojtjen mjedisore.
- d. Për masën 44:
 - Punimet e ndërtimit, materialet dhe produktet duhet të respektojnë karakteristikat dhe kërkesat kulturore, arkitektonike, dhe traditën për fshatin/qarkun përkatës;
 - Mobilimi duhet të jetë në përputhje me karakteristikat tradicionale të fshatit/qarkut (jo luksoz).

- Të ketë projektin arkitektonik dhe konstruktiv, preventivin origjinal dhe një përshkrim të investimit, të firmosur dhe vulosur/firmë digitale), nga një inxhinier i licencuar për ndërtim dhe rikonstruksion. Projekti duhet të përmbajë pjesën arkitekturore dhe konstruktive;
- Të ketë 6-10 dhoma;
- e. Aplikuesi duhet të ketë përmbushur detyrimet tatimore, lëshuar nga zyra e tatim taksave për personat fizikë dhe juridikë;
- f. Aplikuesi nuk duhet të jetë në ndjekje penale për mashtrim, korrupsion apo për çdo lloj veprimtarie tjetër të paligjshme;
- g. Aplikuesët nuk duhet të jenë debitor ndaj AZHBR dhe/ose MBZHR;
- h. Aplikuesi nuk duhet të jetë debitor me status më të ulët se 4 ndaj institucioneve financiare;
- i. Investimi nuk duhet të fillojë para lidhjes së kontratës. Leja e ndërtimit/rikonstruksionit sigurohet para lidhjes së kontratës;
- j. Për masën 52, aplikuesi duhet të disponojë markën përkatëse të autorizuar nga Agjencia për Zhvillimin Ekonomik Rajonal në bashkëpunim me MBZHR dhe të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave, si subjekt i autorizuar për përdorimin e markës;
- k. Investime të papranueshme për masën 44 dhe 52: Investime per kazino, lojra fati, loto sporti.

ii. Kriteret konkurruese

a. Vlera investimit të pranuar	85 pikë
b. Numri i vendeve të reja të punës pas investimit	5 pikë
c. Aplikuese femër	5 pikë
d. Aplikuesi me status emigrant	5 pikë
TOTALI	100 pikë

Vlerësimi i aplikimeve:

Vlera e Investimit (Max 85 pikë)

- Sipas masës vlera maksimale e investimit 85 pikë;
- Aplikimet me vlera më të vogla në mënyrë proporcionale sipas formulës:

$$X = \text{Vlerën e aplikimit} * 85 / \text{Vlera max e investimit}.$$

Numri i vendeve të reja të punës pas investimit (Max 5 pikë):

- Aplikuesi me numrin më të lartë të vendeve të reja të punës merr 5 pikë. Aplikuesit e tjerë marrin sipas formulës:

$$X = \text{Nr i vendeve të reja të punës} * 5 / \text{Nr e vendeve maksimale të reja të punës për masën}.$$

Aplikuese femër (5 pikë)

Aplikues me status emigrant (5 pikë)

iii. Dokumentacioni i dorëzuar në AZHBR

- a. Formularin e aplikimit;
- b. Fotokopje e kartës së identitetit/pasaportës biometrike së aplikuesit apo përfaqësuesit ligjor;
- c. Dokumentin e regjistrimit sipas statusit të aplikuesit, nëse nuk gjenerohet nga sistemi;
- d. Certifikata e rezidencës nga nje shtet tjetër, në momentin e aplikimit;

- e. Projektin, preventivin origjinal dhe një përshkrim të investimit, të firmosur dhe vulosur/firmë digitale), nga një inxhinier i licencuar për ndërtim dhe rikonstruksion. Projekti duhet të përmbajë pjesën arkitekturore dhe konstruktive;
- f. Për masën 52, plan biznesin e printuar dhe në CD i detajuar për 5 vjet, sipas modelit standard, të përcaktuar në Aneksin 14, bashkëngjitur këtij udhëzimi;
- g. Dokumenti origjinal ose fotokopje e noterizuar e lejes së ndërtimit/rikonstruksioni, nëse kërkohet nga kuadri ligjor në fuqi;
- h. 3 oferta origjinale shoqëruar, me datë, firmë dhe vulë për çdo lloj investimi, të shoqëruar me formularin e regjistrimit në QKB të subjekteve ofertuese, me specifikimet teknike të krahasueshme dhe vlefshmërinë e ofertës. Ofertuesit nuk duhet të jenë në konflikt interesi me aplikuesin dhe me njëri tjetrin.
- i. Vërtetimin lëshuar nga zyra e tatim taksave për personat fizikë dhe juridikë. Ky dokument duhet të jetë lëshuar jo më shumë se 30 ditë nga data e aplikimit;
- j. Raporti i Kredimarresit nga Banka e Shqipërisë, në rastet e subjekteve juridikë;
- k. Vërtetim nga Gjykata/Prokuroria që aplikuesi nuk është në ndjekje penale për mashtrim, korrupsion apo për çdo lloj veprimtarie tjetër të paligjshme;
- l. Dokumentacionin e pronësisë së tokës, truallit apo godinës ku do investohet në rastet ku aplikohet; duhet akt noterial për dakortësinë e bashkëpronarëve;
- m. Vërtetimin e bankës për numrin e llogarisë bankare;
- n. Për aplikuesin me statusin emigrant, kopje të firmosur të certifikatës së rezidencës permanente ose pasaportës nga një shtet tjetër, në momentin e aplikimit.

I gjithë dokumentacioni i kërkuar kur dorëzohet si fotokopje (me përjashtim të kartës së identitetit ose pasaportës biometrike, formularin e regjistrimit në QKB të ofertuesve) të jetë i noterizuar dhe i lëshuar jo më parë se 3 muaj nga data e aplikimit.

I gjithë dokumentacioni i kërkuar të jetë në gjuhën shqipe ose në rast se është në gjuhë të huaj të jetë i përkthyer nga një përkthyes i autorizuar.

iv. Dokumentacioni dhe kërkesa për financim

Aplikuesi paraqet pranë AZHBR-së kërkesën për financim. Financimi do të realizohet sipas kushteve të përcaktuara në kontratë.

Së bashku me kërkesën për financim aplikuesi paraqet edhe dokumentacionin e mëposhtëm:

- a. Situacionin e punimeve të kryera me faturën tatimore shoqëruar me librezën e masave (për ndërtim ose rikonstruksion);
- b. Faturën/faturat tatimore pajisjeve, shoqëruar me vlerën ekonomike të elementëve përbërës, etj.;
- c. Akt zhdoganimit për pajisjet që vijnë nga jashtë vendit, shoqëruar me specifikimet teknike dhe vlerën të elementëve përbërës;
- d. Transaksionin bankar dhe/ose fotokopje e SWIFT për të gjitha pagesat ndërkombëtare që vërteton transferimin e fondeve nga aplikuesi tek shitësi

MASAT 47, 48, 49

Masa 47: Mbështetje për makineri dhe pajisje për prodhimin e produkteve tradicionale të zonës deri në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 500 000 (pesëqind mijë) lekë.

Masa 48: Mbështetje për marketingun (përfshirë linjat e ambalazhim/paketimit) e produkteve tradicionale të zonës, në 70% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 700 000 (shtatëqind mijë) lekë.

Masa 49: Mbështetje për çdo sipërmarrje të re (start-up) nga individë të moshës nga 22 deri në 35 vjeç, në 50% të vlerës totale të faturave tatimore por jo më shumë se 500 000 (pesëqind mijë) lekë.

i. Kriteret specifike të përfitimit

Përfituesit e mundshëm: Fermer, OJF, SHBB, person fizik ose juridik

- a. Investimet duhet të realizohen në territorin administrativ të një prej 100 fshatrave, të listuara sipas Aneksit 18.
 - b. Për masën 47 dhe 48, investimi në përfundim duhet të përmbushë standardet në fushën përkatëse në përputhje me akomodimin, sigurinë ushqimore dhe mbrojtjen mjedisore.
 - c. Të ketë plan biznesin e detajuar për 5 vjet, sipas modelit standard, të përcaktuar në Aneksin 14, bashkëngjitur këtij udhëzimi:
 - NPV, duhet të dalë ≥ 0 .
 - IRR duhet të dalë \geq Norma e Skontimit.
 - Norma e skontimit që do të përdoret për përllogaritjen e NPV, është norma e obligacioneve të thesarit 2 vjeçare të pranuar nga Banka e Shqipërisë në ankadin e fundit para hapjes së aplikimeve.
 - Në rast të supozimeve të paqarta/pasakta, AZHBR gëzon të drejtën të kërkojë me shkrim informacion shtesë. Nëse nuk arsyetohen dhe mbështeten supozimet me të dhëna faktike të qarta, atëherë ky aplikim skualifikohet.
 - Në rast se nuk plotësohen këto kritere, ose nuk është plotësuar plan biznesi standart, aplikimi skualifikohet.
 - d. Aplikuesi duhet të ketë përmbushur detyrimet tatimore, lëshuar nga zyra e tatim taksave për personat fizikë dhe juridikë;
 - e. Aplikuesi nuk duhet të jetë nëndjekje penale për mashtrim, korrupsion apo për çdo lloj veprimtarie tjetër të paligjshme;
 - f. Aplikuesit nuk duhet të jenë debitor ndaj AZHBR dhe/ose MBZHR;
 - g. Aplikuesi nuk duhet të jetë debitor i keq ndaj institucioneve financiare;
 - h. Investimi nuk duhet të fillojë para lidhjes së kontratës;
- Për masën 49, investime të papranueshme janë investimet në kazino, lojëra fati apo loto sporte.

ii. Kriteret konkurruese

- | | |
|--|-----------------|
| a. Vlera investimit të pranuar | 85 pikë |
| b. Numri i vëndeve të reja të punës pas investimit | 5 pikë |
| c. Aplikuese femër | 5 pikë |
| d. Aplikuesi me status emigrant | 5 pikë |
| TOTALI | 100 pikë |

Vlerësimi i aplikimeve:

Vlera e Investimit (Max 85 pikë)

- Sipas masës vlera maksimale e investimit 85 pikë;
- Aplikimet me vlera më të vogla në mënyrë proporcionale sipas formulës:
 $X = \text{Vlerën e aplikimit} * 75 / \text{Vlera max e investimit}$.

Numri i vendeve të reja të punës pas investimit (Max 5 pikë):

- Aplikuesi me numrin më të lartë të vendeve të reja të punës merr 5 pikë. Aplikuesit e tjerë marrin sipas formulës:
 $X = \text{Nr i vendeve të reja të punës} * 5 / \text{Nr e vendeve maksimale të reja të punës për masën}$.

Aplikuese femër (5 pikë)

Aplikues me status emigrant (5 pikë)

iii. Dokumentacioni i dorëzuar në AZHBR

- Formularin e aplikimit;
- Fotokopje e kartës së identitetit/pasaportës biometrike së aplikuesit apo përfaqësuesit ligjor;
- Dokumentin e regjistrimit sipas statusit të aplikuesit, nëse nuk gjenerohet nga sistemi;
- Plan biznesi i printuar dhe në CD i detajuar për 5 vjet, sipas modelit standard, të përcaktuar në Aneksin 14, bashkëngjitur këtij udhëzimi;
- Për aplikuesin me statusin emigrant, kopje të firmosur të certifikatës së rezidencës permanente ose pasaportës nga një shtet tjetër, në momentin e aplikimit;
- 3 oferta origjinale, me datë, firmë dhe vulë për çdo lloj investimi, të shoqëruar me QKR-të përkatëse të subjekteve ofertuese, me specifikimet teknike të krahasueshme dhe vlerën ekonomike të elementeve përbërës, si dhe vlefshmërinë e ofertës. Ofertuesit nuk duhet të jenë në konflikt interesi me aplikuesin dhe me njëri tjetrin;
- Vërtetimin lëshuar nga zyra e tatim taksave për personat fizikë dhe juridikë. Ky dokument duhet të jetë lëshuar jo më shumë se 30 ditë nga data e aplikimit;
- Raporti i kredimarresit nga Banka e Shqipërisë;
- Vërtetim nga Gjykata/Prokuroria që aplikuesi nuk është në ndjekje penale për mashtrim, korrupsion apo për çdo lloj veprimtarie tjetër të paligjshme;
- Leje apo licenca sipas legjislacionit në fuqi për aktivitetin që mbështetet;
- Dokumentacionin e pronësisë së tokës, truallit apo godinës ku do investohet;
- Vërtetimin e bankës për numrin e llogarisë bankare.

I gjithë dokumentacioni i kërkuar më sipër kur dorëzohet si fotokopje (me përjashtim të kartës së identitetit ose pasaportës biometrike, formulari i regjistrimit në QKB të subjekteve ofertuese), duhet të jetë i noterizuar dhe i lëshuar jo më parë se 3 muaj nga data e aplikimit.

I gjithë dokumentacioni i kërkuar të jetë në gjuhën shqipe ose në rast se është në gjuhë të huaj të jetë i përkthyer nga një përkthyes i autorizuar.

iv. Dokumentacioni dhe kërkesa për financim

Aplikuesi paraqet pranë AZHBR-së kërkesën për financim. Financimi do të realizohet sipas kushteve të përcaktuara në kontratë.

Së bashku me kërkesën për financim aplikuesi paraqet edhe dokumentacionin e mëposhtëm:

- a. Faturën/faturat tatimore pajisjeve, shoqëruar me vlerën e elementëve përbërës.;
- b. Akt zhdoganimit për pajisjet që vijnë nga jashtë vendit, shoqëruar me specifikimet teknike dhe vlerën e elementëve përbërës;
- c. Transaksionin bankar dhe/ose fotokopje e SËIFT për të gjitha pagesat ndërkombëtare që vërteton transferimin e fondeve nga aplikuesi tek shitësi

Masa 50: Mbështetje për përmirësimin e kushteve në stane për bagëtitë e imta (rikonstruksion dhe pajisje me panele fotovoltaike)

i. Kritere specifike të përfitimit

Përfituesit e mundshëm: Fermerë individual ose grup fermerësh dhe persona fizik ose juridik

- a. Të ketë jo më pak se 100 krerë dele dhe/ose dhi të matrikulluara;
- b. Të shfrytëzojnë kullotat verore me kontratë dhe të ketë leje nga AKZM, (në rastin kur janë zona të mbrojtura) ose bashkinë përkatëse;
- c. Stani të jetë në vendet ku tradicionalisht kanë qenë stanet e vjetra dhe ngrihen sot ndërtesa provizore të staneve / ose vende të parashikuar për ndërtime në planin aktual të menaxhimit.
- d. Të mundësojë akomodim, ushqim, vend pushimi dhe ngrënie, mundësi vendosje kampingu, banjo-dushe, ambient përpunim bulmeti në kushte familjare dhe vathë për bagëtitë.
- e. Ndërtimet të bëhen me materiale ndërtimi lokale si: ndërtesa me gurë, çatia dhe mbulesa me dërrase ose kashtë, mobilimi në ambientet e qëndrimit me objekte druri, banjot e thjeshta me dru ose gur (qeramike -allaturka) dhe gropa septike.

ii. Kriteret konkurruese

- | | |
|----------------------------------|-----------------|
| a. Vlera e investimit të pranuar | 60 pikë |
| b. Nr i krerëve | 40 pikë |
| TOTALI | 100 pikë |

Vlerësimi i aplikimeve:

Vlera e Investimit (Max 60pikë)

- Sipas masës vlera maksimale e investimit 60 pikë;
- Aplikimet me vlera më të vogla në mënyrë proporcionale sipas formulës:
 $X = \text{Vlerën e aplikimit} * 60 / \text{Vlera max e investimit}$.
- Sipas masës, numri maksimal i krerëve 40 pikë;
- Aplikimet me vlera më të vogla në mënyrë proporcionale sipas formulës:
 $X = \text{Numri i krerëve në aplikim} * 40 / \text{Vlera maksimale e numrit të krerëve}$.

iii. Dokumentacioni i dorëzuar në AZHBR

- a. Formularin e aplikimit;
- b. Regjistrin elektronik të matrikujve, me firmë dhe vulë të veterinerit/ përgjegjësit të shërbimit veterinar të konfirmuar nga DB, në rastin kur nuk gjenerohet nga sistemi.

- c. Fotokopje e firmosur e kartës së identitetit/pasaportës biometrike së aplikuesit apo përfaqësuesit ligjor;
- d. Vërtetimin e bankës për numrin e llogarisë bankare;

iv. Dokumentacioni dhe kërkesa për financim

Aplikuesi paraqet pranë AZHBR-së kërkesën për financim. Financimi do të realizohet sipas kushteve të përcaktuara në kontratë.

Së bashku me kërkesën për financim aplikuesi paraqet edhe dokumentacionin e mëposhtëm:

- a. Situacionin e punimeve të kryera ose bazës materiale të blerë me faturën tatimore;
- b. Faturën/faturat tatimore të pajisjeve fotovoltaike, shoqëruar me specifikimet teknike, dhe vlerën ekonomike të elementëve përbërës, etj.;

IX. PROCEDURAT E APLIKIMIT, PËRZGJEDHJES, VERIFIKIMIT DHE EKEZEKUTIMIT TË PAGESAVE PËR MASAT 12, 20-24, 32-36, 40 DHE 44-52

1. AZHBR, nëpërmjet Zyrës së Protokollit, pranon dosjet e aplikimit me dokumentacionin përkatës dhe plotëson formularin e pranimit. Një kopje e këtij formulari i jepet aplikuesit.
2. Dosja e aplikimit duhet të përmbajë të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas masës mbështetëse.
3. Aplikuesit informohen zyrtarisht lidhur me mangësitë në dokumentacion të administruar në dosjen e aplikimit, dhe u lihet një afat 10 ditë pune për plotësimin dhe dorëzimin e tyre zyrtar në AZHBR. Dorëzimi i dokumenteve pjesorë apo përtej afatit të përcaktuar, është kriter skualifikimi (më përjashtim të dokumentit të lejes së ndërtimit).
4. Mbas plotësimit të dosjes dhe përputhshmërisë së kriterëve, aplikimet vlerësohen me pikë, sipas kriterëve të vlerësimit për çdo masë përkatëse.
5. Aplikuesit renditen sipas rendit zbritës të pikëve. Për aplikimet me pikë të barabarta, zbatohet parimi “Kush vjen i pari renditet i pari”.
6. Për aplikuesit e renditur mbi vijën, referuar tavaneve të financimit bëhet ***kontrolli praparak në terren***, dhe nëse rezultojnë në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë udhëzim, AZHBR lidh kontratën përkatëse dhe shpall ***listën e fituesve***.
7. Grupi i kontrollit në terren bën verifikimin në vend të aplikimit, duke lajmëruar paraprakisht aplikuesin për praninë e tij ose të përfaqësuesit ligjor të pajisur me prokurë.
8. Grupi i kontrollit në prani të aplikuesit ose të përfaqësuesit ligjor, kryen verifikimet e nevojshme dhe plotëson raportin e verifikimit sipas masës përkatëse. Raporti i verifikimit firmoset nga aplikuesi/përfaqësuesi i tij ligjor dhe gjithë grupi i verifikimit. Për çdo rast aplikuesi ose ndonjë përfaqësues i grupit të verifikimit mund të bëjë observimet e nevojshme dhe të firmosë për to.

Mangësi skualifikuese, janë si më poshtë:

- Mungesa e plotësimit të planit të biznesit, sipas përcaktimeve në secilën nga masat përkatëse.
- Mungesa e të paktën njëres prej tre ofertave origjinale me datë, firmë dhe vulë për çdo lloj investimi, të shoqëruar me specifikimet teknike të krahasueshme dhe vlerën për çdo element përbërës, si dhe vlefshmërinë e ofertës;
- Ofertuesit janë në konflikt interesi (palë të lidhura) me aplikuesin ose me njëri tjetrin;
- Mungesa e pjesës arkitekturore ose konstruktive e projektit origjinal, i firmosur dhe i vulosur nga një inxhinier i licencuar për ndërtim dhe rikonstruksion;
- Mungesa e preventivit origjinal, i firmosur dhe i vulosur nga një inxhinier i licencuar për ndërtim dhe rikonstruksion;
- Paraqitja e dokumenteve/deklarimeve të rreme (fiktive).

Aplikuesit informohen zyrtarisht lidhur me mangësitë e dokumentave që nuk janë pjesë e dokumentave të renditura më sipër, në dokumentacion të administruar në dosjen e aplikimit, dhe u lihet një afat 10 ditë pune për plotësimin dhe dorëzimin e tyre zyrtar në AZHBR. Dorëzimi i

dokumenteve pjesorë apo përtej afatit të përcaktuar, është kriter skualifikimi (më përjashtim të dokumentit të lejes së ndërtimit, e cila duhet paraqitet para lidhjes së kontratës).

Lëvizja e vizës së financimit dhe rialokimi i fondeve

9. Nëse nga “kontrolli administrativ” dhe “Kontrolli në terren”, rezultojnë aplikime të refuzuara nga AZHBR për mosplotësim të kritereve të përfitimit apo moskryerje të investimit, bëhet plotësimi i fondit më fitues të tjerë të masës nga aplikuesit e radhës;
10. Për projektet e skualifikuara nga kontrollet administrative dhe në terren, AZHBR njofton aplikuesit duke bashkëngjitur edhe arsyen e skualifikimit;
11. Në momentin e verifikimit mbas kryerjes së investimit për masën 12, kur nga verifikimi në terren rezultojnë diferenca në sipërfaqen e serrës së ndërtuar deri në 10% krahasuar me sipërfaqen e deklaruar në aplikim, bëhet rivlerësimi i renditjes në listën e fituesve.
Ndërsa për diferenca mbi 10%, pagesa bëhet për sipërfaqen faktike duke zbritur dyfishin e diferencës së sipërfaqes, për pjesën takuese të mbështetjes referuar faturave përkatëse;
12. Në momentin e verifikimit mbas kryerjes së investimit për masat 20-24, 32-36, 40 dhe 44-52 kur nga verifikimi në terren rezultojnë diferenca në vlerën e investimit dhe në volumin e punimeve të realizuara mbi 10% krahasuar me vlerën e kontraktuar, pagesa të bëhet për vlerën faktike duke zbritur dyfishin e diferencës së vlerës për pjesën takuese të mbështetjes referuar faturave përkatëse.

X. KONTROLI PËR ADMINISTRIMIN E FONDIT DHE ÇËSHTJE TË TJERA

1. AZHBR është përgjegjëse për zbatimin, auditimin dhe likuidimin financiar të përfituesve sipas masave të mbështetjes dhe kriterëve të përfitueshmërisë.
2. AZHBR gëzon të drejtën për të kërkuar dokumentacion shtesë, në rast se e gjykon të arsyeshme brenda kriterëve të miratuara.
3. MBZHR, AZHBR dhe AKSHI hartojnë dhe zbatojnë një plan trainimi me të gjithë stafin që do të përfshihet në procedurën e aplikimit on line, me 0 dokument në aplikim.
4. MBZHR dhe AZHBR hartojnë dhe zbatojnë një plan informimi dhe ndërgjegjësimi me të gjithë grupet e interesit për masat e përfitimit, kriteret dhe kushtet që duhet të plotësojnë të gjithë përfituesit potencialë për të përfituar mbështetje financiare nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural.
5. Në rastet kur numri i aplikuesve të një mase nuk plotëson tavanin e financimit për masën përkatëse, rialokimi i fondeve në masat e tjera bëhet me Urdhër të ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, sipas propozimit të AZHBR.
6. Fondi i parashikuar, në zërin “Transferte në buxhete familjare”, për realizimin e shërbimit “Mbështetje deri në 85 000 lekë për njësi sipas faturës tatimore për sistemet e monitorimit të anijes për pajisjet MTU (Njësi Transmetuese të Sinjalit) të instaluar në bordin e anijeve të peshkimit për identifikimin dhe lokalizimin e anijeve nëpërmjet satelitit”, të kalojë sipas procedurave ligjore në zërin 602 të shpenzimeve operative të AZHBR-së.
7. Mënyra e procedimit të aprovimit, verifikimit, autorizimit dhe pagësës së aplikimeve përshkruhet në “Manualin e procedurave për implementimin e masave kombëtare”, të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i AZHBR-së.
8. Formularët/raportet e verifikimit në terren, sipas masave/grup masave mbështetëse, përgatiten nga AZHBR në përputhje dhe në zbatim të këtij udhëzimi.
9. Aplikuesit, të cilët skualifikohen gjatë implementimit të masave mbështetëse paraqesin ankesën e tyre brenda 10 ditëve pune nga marrja e njoftimit pranë AZHBR. AZHBR brenda 10 ditëve pune nga marrja e ankesës bën verifikimin përkatës dhe i jep përgjigje ankimesit.
10. Për vlerësime të aplikimeve në masat e investimeve, në rastet ku përfshihen zëra punimesh ndërtimore, etj, AZHBR mund të kontraktojë me kohë të kufizuar ekspertë të licencuar të fushës.
11. Mbështetja financiare llogaritet mbi vlerën e faturës tatimore, përfshirë vlerën TVSH.
12. Në kontratën që AZHBR do të nënshkruajë me aplikuesin fitues, duhet të përcaktohen qartë penaltetet në rastet kur përfituesi i fondeve të masave mbështetëse nuk pranon të kontrollohet prej inspektorëve të AZHBR-së.
13. Në rast të konstatimit të “kundravajtjeve administrative”, nga ana e përfituesit në drejtim të tjetërsimit të qëllimit për të cilën janë marrë fondet apo mos mbajtjes së dokumentacionit të

përdorur për përfitimin e fondeve për një periudhë 5 vjeçare, AZHBR propozon sanksione të përcaktuara në nenin 39, të ligjit 9817, datë 22. 10. 2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”.

14. Në rast se konstatohen shkelje të rregullave në administrimin e fondeve nga personat përgjegjës në AZHBR, merren masa disiplinore apo zhdëmtim për çdo rast sipas dispozitave ligjore në fuqi.
15. Për menaxhimin e fondeve AZHBR raporton në MBZHR në mënyrë periodike. MBZHR raporton çdo tremujor në MFE për ecurinë e realizimit të programit të mbështetjes financiare.
16. Për zbatimin e këtij Udhëzimi ngarkohen Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, Ministria e Financave dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

**MINISTRI I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL**

NIKO PELESHI



**MINISTRI I FINANCAVE DHE
EKONOMISË**

ARBEN AHMETAJ



ANEKSET

Aneksi 1. Harta bujqësore për masat mbështetëse

Aneksi 2. Numri i masave mbështetëse që mund të përfitojnë një aplikues

Aneksi 3. Formulari i regjistrimit të fermës

Aneksi 4. Lista e zyrave të aplikimit

Aneksi 5. Formulari për masat 1-6, 8 dhe 9

Aneksi 5/1. Formulari për masën 7

Aneksi 6. Formulari për masën 13

Aneksi 7. Formulari për masën 14

Aneksi 8. Formulari për masën 17

Aneksi 9. Formulari për masën 19

Aneksi 10. Formulari për masën 15

Aneksi 11. Speciet dhe kultivarët për masat 1-11

Aneksi 12. Numri minimal i bimëve për ha sipas specieve për masat 1-11

Aneksi 12/1. Numri minimal i bimëve për ha sipas specieve

Aneksi 13. Specifikimet teknike të pajisjes MTU

Aneksi 14. Modeli standard i plan biznesit

Aneksi 15. Formulari për masën 12

Aneksi 16. Specifikimet teknike sipas tipit të serrave

Aneksi 17 Parametrat/normat për krerë për ndërtimin e ambienteve për mbarështimin e kafshëve

Aneksi 18. Lista e 100 fshatrave

Aneksi 19. Produktet tradicionale